FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 117

Tiranë – E martë, 23 maj 2017

PËRMBAJTJA

		Faqe
Ligj nr. 87/2017 datë 4.5.2017	Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, "Huamarrësi", dhe KfW Frankfurt am Main, "KfW", për programin e infrastrukturës bashkiake III/IV, furnizimi me ujë dhe kanalizime për vendndodhjet e projekteve Berat - Kuçovë, Delvinë, Gjirokastër, Kamëz, Librazhd dhe Lushnjë.....	6115
Ligj nr. 88/2017 datë 4.5.2017	Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2016, për projektin "Fondi arsimor për formimin profesional dhe punësimin".....	6132
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 428, datë 17.5.2017	Për një ndryshim në vendimin nr. 592, datë 5.9.2007, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e personaliteteve të tjera të larta shtetërore të vendit, që do të ruhen dhe mbrohen nga Garda e Republikës së Shqipërisë edhe pas lirimit nga funksioni".....	6134
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 429, datë 17.5.2017	Për disa shtesa në vendimin nr. 1719, datë 17.12.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave të ankandit publik", të ndryshuar.....	6134
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 431, datë 17.5.2017	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 418, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njësive të qeverisjes qendrore", të ndryshuar.....	6135
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 432, datë 17.5.2017	Për rishpërndarje fondesh, nga Ministria e Zhvillimit Urban në Agjencinë për Zhvillimin Ekonomik Rajonal, për grantin "Nënprogrami i mbështetjes financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM)", miratuar me vendimin nr. 14, datë 21.3.2017, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve.....	6136

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 433, datë 17.5.2017	Për disa ndryshime në vendimet nr. 1481, datë 12.11.2008; nr. 100, datë 27.1.2009; nr. 167, datë 19.2.2009; nr. 286, datë 18.3.2009; nr. 450, datë 6.5.2009; nr. 611, datë 11.6.2009; nr. 677, datë 18.6.2009; nr. 706, datë 23.6.2009; nr. 805, datë 22.7.2009; nr. 1038, datë 14.10.2009; nr. 1283, datë 23.12.2009; nr. 125, datë 17.2.2010; nr. 404, datë 26.5.2010; nr. 549, datë 7.7.2010; nr. 646, datë 28.7.2010; nr. 118, datë 17.2.2011; nr. 822, datë 23.11.2011; nr. 513, datë 1.8.2012; nr. 61, datë 23.1.2013; nr. 345, datë 24.4.2013; nr. 490, datë 18.6.2013; nr. 501, datë 10.6.2015; nr. 279, datë 1.4.2015; nr. 615, datë 7.7.2015; nr. 882, datë 30.10.2015; nr. 1094, datë 28.12.2015; nr. 871, datë 14.12.2016, të Këshillit të Ministrave, për miratimin e kalimit të pronësisë së disa parcelave ndërtimore, në favor të poseduesve të objekteve informale, të ndryshuar.....	6137
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 434, datë 17.5.2017	Për disa ndryshime në vendimet e Këshillit të Ministrave nr. 389, datë 19.5.2010, nr. 901, datë 12.12.2012, dhe nr. 449, datë 27.5.2015, për shpërblimin e pronarëve për sipërfaqet takuese të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga ndërtimet informale.....	6149
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 435, datë 17.5.2017	Për një ndryshim në vendimin nr. 504, datë 6.7.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve"	6150
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 436, datë 17.5.2017	Për procedurën e pajtimit dhe shpërblimin e anëtarëve të zyrave shtetërore të pajtimit.....	6150
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 437, datë 17.5.2017	Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e drejtorive të ujitjes dhe të kullimit Lezhë, Durrës, Fier dhe Korçë.....	6151
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 438, datë 17.5.2017	Për një ndryshim në vendimin nr. 438, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për kriteret dhe rregullat e shfrytëzimit të pyjeve dhe të shitjes së materialit drusor e të prodhimeve të tjera pyjore e jopyjore"	6152
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 440, datë 17.5.2017	Për përcaktimin e standardeve, të kritereve dhe procedurave të akreditimit të ofruesve të aktiviteteve të edukimit në vazhdim për profesionistët e shëndetësisë.....	6152
Kërkesë e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës nr. 2869, datë 16.5.2017	Për shpronësimet për interes publik, të pasurive pronë private që preken nga zbatimi i projektit "Riveshje-sistemim-asfaltim-masa inxhinierike, rruga Këlcyrë-Përmet (loti 3)", për pasuritë e llojit "pyll"	6156
Kërkesë e Ministrisë së Punëve të Brendshme nr. 1509/7, datë 16.5.2017	Për shpronësim, për interes publik të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Sistemim blloqe banimi Zogu I, Krahu i djathtë (Zyra e Punës, Drejtoria e Bujqësisë), Bashkia Shkodër.....	6157

LIGJ
Nr. 87/2017

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES SË HUAS NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, "HUAMARRËSI", DHE KFW FRANKFURT AM MAIN, "KFW", PËR PROGRAMIN E INFRASTRUKTURËS BASHKIAKE III/IV, FURNIZIMI ME UJË DHE KANALIZIME PËR VENDNDODHJET E PROJEKTEVE BERAT - KUÇOVË, DELVINË, GJIROKASTËR, KAMËZ, LIBRAZHD DHE LUSHNJË

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja e huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, "Huamarrësi", dhe KfW Frankfurt am Main, "KfW", për financimin e programit të infrastrukturës bashkiake III/IV, furnizimi me ujë dhe kanalizime për vendndodhjet e projekteve Berat - Kuçovë, Delvinë, Gjirokastër, Kamëz, Librazhd dhe Lushnjë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 4.5.2017

Shpallur me dekretin nr. 10341, datë 18.5.2017 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJE HUAJE
DATË _____
NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, TË PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE ("HUAMARRËSI") DHE KFW, FRANKFURT AM MAIN ("KFW") PËR 35,000,000.00 EURO BMZ-ID 2011 659 68 DHE 2012 658 67
HUAJA NR. 27227
PËR PROGRAMIN E INFRASTRUKTURËS BASHKIAKE III/IV FURNIZIMI ME UJË DHE KANALIZIMET PËR VENDNDODHJET E PROJEKTEVE BERAT - KUÇOVË, DELVINË, GJIROKASTËR, KAMËZ, LIBRAZHDIT DHE LUSHNJË ("PROGRAMI")

HYRJE

Baza për këtë Marrëveshje Huaje ndërmjet KFW-së dhe Huamarrësit (Marrëveshja ose Marrëveshja e Huasë) janë marrëveshjet që do të lidhen ndërmjet Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë mbi "Bashkëpunimin Financiar" (BF) ("Marrëveshje Qeveritare").

Kjo Marrëveshje Huaje është pjesë e Programit të Infrastrukturës Bashkiake III/IV. Kjo marrëveshje vijon mbështetjen e dhënë për Huamarrësin gjatë Fazës 1 të këtij Programi (me anë të një Marrëveshje Financimi datë 28 Gusht 2015 ("Marrëveshje e Financimi FS Faza 1") dhe një Marrëveshje Financimi datë 28 Gusht 2015 ("Marrëveshje Financimit SECO Faza 1").

Faza 2 e Programit të Infrastrukturës Bashkiake III/IV do të zbatohet me anë të kësaj Marrëveshje Huaje, Marrëveshjes së Financimit datë _____ ("Marrëveshje Financimi SECO II") dhe Marrëveshje Financimi datë _____ ("Marrëveshje Financimi II").

Baza për lidhjen e kësaj Marrëveshje Huaje lidhet me Këstin I të Programit "Infrastruktura Bashkiake III – Furnizimi me ujë dhe Kanalizimet për qytetet e Beratit, Kuçovës dhe Librazhdit" (BMZ No. 2011 659 68) dhe Këstit II të Programit "Infrastruktura Bashkiake IV – Furnizimi me ujë dhe Kanalizimet për qytetet e

Delvinës ,Gjirokastrës, Kamzës dhe Lushnjës" (BMZ Nr. 2012 658 67) (bashkërisht "Programi") të planifikuara nga Huamarrësi.

KfW-ja do të rifinancojë Huanë e dhënë në pajtim me kushtet e kësaj Marrëveshjeje, me subvencionet e interesit nga fondet e buxhetit me interes të ulët të garantuara nga Republika Federale e Gjermanisë për projekte që përmbushin kriteret e përshtatshmërisë së zhvillimit të politikave. Termat dhe kushtet e Huasë përputhen me kërkesat e OECD-së të zbatueshme në datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje për njohjen si Asistencë Zyrtare për Zhvillim (ODA).

Mbi këtë bazë dhe me kusht që Republika Federale e Gjermanisë të japë një garanci për huanë, KfW-ja do të japë një Kredi në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje Huaje.

1. Huaja

1.1 *Shuma:* KfW-ja do t'i japë Huamarrësit një Hua që nuk kalon një total prej 35,000,000.00 EURO (" Huaja") (me fjalë : tridhjetë e pesë milionë Euro),

Në një këst prej 15,000,000.00 Euro ("Kësti 1" BMZ-ID 2011 659 68) (me fjalë: pesëmbëdhjetë milionë Euro),

Dhe një këst prej 20,000,000.00 Euro ("Kësti 2" BMZ-ID 2012 658 67 (me fjalë: njëzet milionë Euro).

1.2 *Qëllimi.* Huamarrësi e përdor Huanë vetëm për financimin e Programit, me anë të kanalizimit plotësisht të Kështit 1 të Huasë tek ndërmarrjet e ujit UK Berat-Kuçovë dhe UK Librazhd dhe Kështit 2 tek ndërmarrjet e ujit UK Delvinë, UK Gjirokastër, UK Lushnje dhe tek drejtoria e ujësjellësit në bashkinë e Kamzës (bashkërisht "Agjencitë e Zbatimit të Projektit"ose "AZP-të ", secila prej tyre "Agjencia e Zbatimit të Projektit"ose "AZP") në pajtim me kushtet e parashikuara në Nenin 2. Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Agjencia Kombëtare e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve, do të veprojnë si Njësi e Koordinimit të Programit ("Njësia e Koordinimit të Programit" ose "NJKP") për drejtimin, koordinimin dhe zbatimin e përgjithshëm të projektit si edhe për kontraktimin dhe zbatimin e shërbimeve konsulente. Huamarrësi nëpërmjet NJKP-së, në kuadër të programit do të garantojë që secila prej Agjencive të Zbatimit të Projektit të përdorë fondet e Huasë vetëm për financimin e investimeve për përmirësimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në qytetet përkatëse, (secili prej tyre një "Projekt"). Njësia e Koordinimit të Programit, Agjencitë e Zbatimit të Projektit dhe KfW-ja do të përcaktojnë hollësitë e Programit dhe furnizimet, mallrat, punimet dhe shërbimet që do të financohen nga Huaja me anë të një Marrëveshjeje të Veçantë II që do të bashkë-nënshkruhet nga Huamarrësi, i përfaqësuar nga Ministria e Financave ("Marrëveshje e Veçantë II").

1.3 *Tatimet taksat dhe detyrimet doganore:* Tatimet dhe taksat e tjera publike për të cilat detyrohet Huamarrësi apo secila prej AZP-ve si dhe detyrimet doganore nuk mund të financohen nga Huaja.

2. Kanalizimi i Huasë tek Agjencitë e Zbatimit të Projektit

2.1 *Marrëveshja e Nën-huasë.* Përveç kur bihet dakord ndryshe me pëlqimin paraprak të KfW-së, Huamarrësi e kanalizon Huanë të përcaktuar në Euro apo ekuivalentin në Lekë Shqiptar tek Agjencitë e Zbatimit të Projektit sipas Marrëveshjeve të Nën-huasë për një afat prej 40 vjetësh duke përfshirë një periudhë pa pagesa (pagesa interesi, principali dhe tarife) prej 10 vjetësh. Interesi dhe tarifat e pagueshme nën Marrëveshjen e Nën-huasë nuk kalon shumën totale të interesit dhe tarifave që paguhen sipas Nenit 4 dhe 5.1.

2.2 *Përkthimi i Çertifikuar.* Para disbursimit të parë nga Huaja, Huamarrësi i dërgon KfW-së një përkthim të çertifikuar në Anglisht ose Gjermanisht të secilës prej Marrëveshjeve të Nën-huasë të specifikuar në Nenin 2. 1.

2.3 *Mungesa e Përgjegjësisë së Agjencisë së Zbatimit të Projektit.* Kanalizimi i Huasë nuk përbën përgjegjësi të ndonjë Agjencie të Zbatimit të Projektit kundrejt KfW-së për detyrimet e pagesës sipas Marrëveshjes së Huasë.

3. Disbursimi

3.1 *Kërkesat për disbursim.* Sapo të përmbushen të gjitha kushtet paraprake për disbursimin në pajtim me Nenin 3.3, KfW-ja disburson Huanë në pajtim me progresin e Projekteve dhe me kërkesë të Huamarrësit nëpërmjet NJKP-së. Disbursimet realizohen në

pajtim me grafikun e disbursimit që gjendet në Aneksin 1 të kësaj Marrëveshjeje Huaje. KfW-ja bën disbursime vetëm deri në shumat maksimale të përcaktuara për çdo gjashtë mujor. Në masën që Huamarrësi kërkon disbursimin e shumave të vogla brenda një gjysmë viti, shumat e padisbursuara mund të kërkohen në çdo periudhë pasuese gjashtë mujore. Me përjashtim të disbursimit të fundit, KfW-ja nuk është e detyruar të realizojë disbursime në një shumë më të vogël se 200,000.00 Euro.

3.2 *Afati për kërkimin e disbursimit*. KfW-ja mund të refuzojë disbursimet pas datës 31 dhjetor 2022 apo ndonjë datë tjetër për të cilën të dy palët bien dakord.

3.3 *Kushtet Paraprake për Disbursimin.* KfW-ja është e detyruar të bëjë disbursimet e çdo shume sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje vetëm me përmbushjen e kushteve të mëposhtme paraprake në formën dhe përmbajtjen e pranueshme për KfW-në:

a) Huamarrësi ka demonstruar duke paraqitur një opinion ligjor, me përmbajtje sipas parashikimit në Aneksin 2 dhe duke paraqitur kopje të çertifikuara (secila me një përkthim zyrtar në gjermanisht ose anglisht) të të gjithë dokumenteve të cilave u referohet Opinioni Ligjor, që Marrëveshja e Huasë është ligjërisht e efektshme dhe e zbatueshme dhe, veçanërisht që:

i) Huamarrësi ka përmbushur të gjitha kërkesat sipas ligjit të vet kushtetues dhe dispozitave të tjera ligjore për marrjen përsipër në mënyre të vlefshme të të gjithë detyrimeve të tij sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe

ii) KfW-ja përjashtohet nga të gjitha tatimet mbi të ardhurat nga interesat, detyrimet, tarifat dhe kostot e ngjashme në Shqipëri kur jep Huanë.

b) palët kanë një kopje origjinale të kësaj Marrëveshjeje dhe të Marrëveshjes së Veçantë II, secila e nënshkruar ligjërisht;

c) modelet e nënshkrimeve të përmendura në Nenin 13.1 (Përfaqësimi i Huamarrësit) janë marrë nga KFW-ja;

d) Garancia nga Republika Federale Gjermane e përmendur në Nenin 8 është në fuqi pa kufizim;

e) Huamarrësi ka paguar Tarifën e Menaxhimit të parashikuar në Nenin 4.2;

f) nuk ka ndodhur ose nuk rrezikon të ndodhë asnjë shkak për zgjidhje marrëveshjeje me anë të një njoftimi, apo përfundimi afati apo vërtetimi apo përmbushjes së një kushti (arsye potenciale për përfundim); dhe

g) nuk kanë lindur rrethana të jashtëzakonshme që përjashtojnë ose rrezikojnë seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e Programit, ose përmbushjen e detyrimeve të pagesës të marra përsipër nga Huamarrësi sipas Marrëveshjes së Huasë. Para disbursimit nga Huaja, KfW-ja ka të drejtën për të kërkuar dokumente dhe prova të tjera që çmohen të nevojshme për të vlerësuar përmbushjen e kushteve paraprake të specifikuara në këtë paragraf.

3.4 *Detaje të Procedurës së Disbursimit*. NJKP, AZP-të dhe KfW në një Marrëveshje të Veçantë II që duhet të kundërfirmoset nga Huamarrësi, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, specifikojnë procedurën e disbursimit, duke përfshirë kushte specifike paraprake për disbursimin dhe veçanërisht provat që duhet të paraqiten nga Huamarrësi nëpërmjet NJKP-së që provojnë se shumat e kërkuara të huasë përdoren për qëllimin e parashikuar, si edhe detyrimin e NJKP-së për të informuar Ministrinë e Financave në lidhje me shumat e disbursuara përkatësisht për çdo AZP.

3.5 *Heqja dorë nga disbursimi*. Në pajtim me përmbushjen e detyrimeve të veta sipas Nenit 11, Huamarrësi mund të heqë dorë nga disbursimi i shumave të padisbursuara të huasë me marrëveshje të përbashkët të të gjitha palëve në këtë marrëveshje në këmbim të pagesës së Kompensimit të Mos-pranimit në pajtim me Nenin 3.6.

3.6 *Kompensimi i Mospranimit.* Nëse Huamarrësi heq dorë nga disbursimi i një shume të huasë në pajtim me nenin 3.5, ose nëse një shumë Huaje nuk disbursohet ose nuk disbursohet në afatin e caktuar në Nenin 3.2 apo në ndonjë afat tjetër të rënë dakord nga palët , Huamarrësi i paguan KfW-së me kërkesën e saj menjëherë atë shumë që është normalisht e nevojshme për të kompensuar KfW-në për çdo humbje, shpenzim, kosto të pësuar nga KfW-ja si rezultat i mospranimit të

shumës së huasë në fjalë (Kompensimi i mospranimit) përveç rastit kur ky mos-disbursim përbën shkelje të kësaj Marrëveshje nga KfW-ja. KfW-ja llogarit shumën e Kompensimit të Mospranimit dhe ia komunikon Huamarrësit.

4. Tarifat

4.1 *Tarifa e Zotimit Financiar*. Huamarrësi paguan një tarifë zotimi financiar të pakthyeshme prej 0.25% në vit ("Tarifa e Zotimit", me fjalë: zero pikë njëzetë e pesë për qind në vit) për shumat e padisbursuara të Huasë.

Tarifa e Zotimit Financiar bëhet e kërkueshme për pagesë çdo gjysmë viti në fund të periudhës më 30 qershor dhe 30 dhjetor të çdo viti, ku për herë të parë, është e kërkueshme për pagesë më 30 Qershor 2018 por jo më parë se në datën përkatëse, pas datës në të cilën hyn në fuqi kjo Marrëveshje Huaje në pajtim me Nenin 15.10.

Tarifa e Zotimit Financiar do të përrllogaritet nëse është e zbatueshme për periudhën që fillon dymbëdhjetë muaj pasi kjo Marrëveshje të ketë hyrë dhe të jetë në fuqi por jo më vonë se data 1 Korrik 2018 deri në datën e disbursimit të plotë të huasë ose, nëse është e zbatueshme, deri në datën e ndërprerjes përfundimtare të disbursimeve nga Huaja.

4.2 *Tarifa e menaxhimit*. Huamarrësi i paguan KfW-së një shumë të përgjithshme të njëhershme dhe të pakthyeshme si Tarifë Menaxhimi që është e barabartë me 1.0% (në fjalë një pikë zero për qind) të shumës principale të Huasë të përcaktuar në Nenin 1.1 ("Tarifa e Menaxhimit")

Tarifa e Menaxhimit është e pagueshme në rastin më të parë në dy datat e mëposhtme: (i) para disbursimit të parë ose (ii) pas kalimit të një periudhe tremujore pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje nga KfW apo pas kalimit të një periudhe njëmujore pasi të ketë hyrë në fuqi kjo Marrëveshje (në varësi të faktit se cila është data më e vonshme e parashikuar në pikën (ii)). Tarifa e Menaxhimit është e kërkueshme për pagesë pasi kjo Marrëveshje të nënshkruhet, pavarësisht faktit nëse Huaja është disbursuar plotësisht apo pjesërisht apo aspak.

5. Interesi

Huamarrësi i paguan KfW-së interesin si më poshtë:

5.1 *Interesi*. (normë fikse interesi qe caktohet me angazhimin e Huasë). Huamarrësi paguan një interes për Huanë në normën që përcaktohet nga KfW-ja një ditë Bankare pasi KfW-ja të ketë marrë njoftim që Marrëveshja ka hyrë në fuqi (data e marrjes nga KfW) ("Normë fikse interesi") deri sa të jetë marrë shlyerja e këstit të fundit në pajtim me Grafikun e Shlyerjes sipas përcaktimit në Nenin 6.1. KfW e njofton Huamarrësin mbi normën e interesit brenda një afati prej pesë ditësh Bankare pas përcaktimit të tij.

5.2 *Llogaritja e Interesit*. Interesi për një shumë të disbursuar të Huasë do të llogaritet nga data (duke e përjashtuar atë) në të cilën paguhet shuma përkatëse e huasë nga llogaria e Huasë që mbahet tek KfW-ja për huamarrësin deri në datën (duke e përfshirë atë) në të cilën shlyerjet përkatëse kreditohen tek llogaria e KfW-së e përcaktuar në Nenin 7.3. Interesi përllogaritet në pajtim me Nenin 7.1.

5.3 *Data e Pagesës*. Interesi do të bëhet i kërkueshëm për shlyerje në datat e caktuara më poshtë (secila "Datë Pagese"):

a) para datës së caktuar të këstit të parë të shlyerjes, më 30 qershor dhe 30 dhjetor të çdo viti, për herë të parë më 30 qershor 2018; por jo më herët se në Datën e Pagesës pas ditës në të cilën kjo Marrëveshje hyn në fuqi në pajtim me nenin 15.10.

b) në datën e caktuar të këstit të parë të shlyerjes në pajtim me Nenin 6.1 të këtij Neni, së bashku me këtë këst;

c) më pas në datat e caktuara të kësteve të shlyerjes në pajtim me Nenin 6.1.

6. Shlyerja dhe parapagimi

6.1 *Grafiku i shlyerjes*. Huamarrësi e shlyen Huanë si më poshtë:

Kësti 1:

Kësti	Data		Shuma	
1	30 Qershor	2020	600,000.00	EURO
2	30 Dhjetor	2020	600,000.00	EURO
3	30 Qershor	2021	600,000.00	EURO
4	30 Dhjetor	2021	600,000.00	EURO
5	30 Qershor	2022	600,000.00	EURO
6	30 Dhjetor	2022	600,000.00	EURO
7	30 Qershor	2023	600,000.00	EURO
8	30 Dhjetor	2023	600,000.00	EURO
9	30 Qershor	2024	600,000.00	EURO
10	30 Dhjetor	2024	600,000.00	EURO
11	30 Qershor	2025	600,000.00	EURO
12	30 Dhjetor	2025	600,000.00	EURO
13	30 Qershor	2026	600,000.00	EURO
14	30 Dhjetor	2026	600,000.00	EURO
15	30 Qershor	2027	600,000.00	EURO
16	30 Dhjetor	2027	600,000.00	EURO
17	30 Qershor	2028	600,000.00	EURO
18	30 Dhjetor	2028	600,000.00	EURO
19	30 Qershor	2029	600,000.00	EURO
20	30 Dhjetor	2029	600,000.00	EURO
21	30 Qershor	2030	600,000.00	EURO
22	30 Dhjetor	2030	600,000.00	EURO
23	30 Qershor	2031	600,000.00	EURO
24	30 Dhjetor	2031	600,000.00	EURO
25	30 Qershor	2032	600,000.00	EURO

Kësti 2:

Kësti	Data		Shuma	
1	30 Qershor	2020	800,000.00	EURO
2	30 Dhjetor	2020	800,000.00	EURO
3	30 Qershor	2021	800,000.00	EURO
4	30 Dhjetor	2021	800,000.00	EURO
5	30 Qershor	2022	800,000.00	EURO
6	30 Dhjetor	2022	800,000.00	EURO
7	30 Qershor	2023	800,000.00	EURO
8	30 Dhjetor	2023	800,000.00	EURO
9	30 Qershor	2024	800,000.00	EURO
10	30 Dhjetor	2024	800,000.00	EURO
11	30 Qershor	2025	800,000.00	EURO
12	30 Dhjetor	2025	800,000.00	EURO
13	30 Qershor	2026	800,000.00	EURO
14	30 Dhjetor	2026	800,000.00	EURO
15	30 Qershor	2027	800,000.00	EURO
16	30 Dhjetor	2027	800,000.00	EURO

17	30 Qershor	2028	800,000.00	EURO
18	30 Dhjetor	2028	800,000.00	EURO
19	30 Qershor,	2029	800,000.00	EURO
20	30 Dhjetor	2029	800,000.00	EURO
21	30 Qershor	2030	800,000.00	EURO
22	30 Dhjetor	2030	800,000.00	EURO
23	30 Qershor	2031	800,000.00	EURO
24	30 Dhjetor	2031	800,000.00	EURO
25	30 Qershor	2032	800,000.00	EURO

6.2 *Shumat e padisbursuara të huasë*. Shumat e padisbursuara të huasë të çdo Transhi do të kompensohen kundrejt shlyerjes së kështit të fundit përkatës të kërkueshëm, në pajtim me grafikun e shlyerjes në pajtim me Nenin 6.1 përveç kur KfW-ja, në tagrin e saj, zgjedh një kompensim tjetër në raste individuale.

6.3 *Shlyerjet në rastin e disbursimit të papërfunduar*. Nëse një këst i shlyerjes bëhet i kërkueshëm para se Huaja të jetë disbursuar plotësisht , kjo nuk cenojë grafikun e shlyerjes në pajtimi me Nenin 6.1 për sa kohë që kësti i kërkueshëm i shlyerjes të jetë më i vogël se shuma e disbursuar e Huasë dhe që nuk është paguar ende (**"Shuma e papaguar e Kredisë"**). Nëse kësti i kërkueshëm i shlyerjes në pajtim me Nenin 6.1 e tejkalon Shumën e Papaguar të Kredisë, ky këst do të ulet në nivelin e Shumës së Papaguar të Kredisë dhe diferenca do të alokohet në mënyrë të barabartë në kështet e shlyerjes që nuk janë paguar ende. Në llogaritjen e Shumës së Papaguar të Kredisë, KfW-ja rezervon të drejtën për të konsideruar disbursimet nga huaja që janë kryer brenda një periudhe prej 45 ose më pak ditë para Datës së Pagesës për të përcaktuar Shumën e Papaguar të Kredisë vetëm për Datën pasuese të Pagesës.

6.4 *Parapagimi*. Sa më poshtë zbatohet për shlyerjet e parakohshme:

a) *E drejta për të kryer pagesa të parakohshme*. Në pajtim me paragrafët e mëposhtëm 6.4 b) deri në 6.4 e) të këtij neni, Huamarrësi ka të drejtë të shlyejë shumat e huasë para datës së caktuar nëse kjo shlyerje është të paktën sa shuma e një kësti shlyerjeje sipas nenit 6.1.

b) *Njoftimi*. Një pagesë e parakohshme e shumës së Huasë në pajtim me Nenin 6.4 a) i nënshtrohet njoftimit të pagesës së parakohshme nga huamarrësi për KfW-në jo më vonë se **Dita** e pesëmbëdhjetë **Bankare** (në pajtim me Nenin 15.1) para datës së synuar për pagesën e parakohshme. Ky njoftim është i parevokueshëm; ai duhet të specifikojë datën në të cilën duhet të kryhet shlyerja e parakohshme dhe shumën e saj dhe e detyron Huamarrësin t'i paguajë KfW-së shumën e përcaktuar në datën e caktuar.

c) *Kompensimi i pagesës së parakohshme*. Nëse Huamarrësi shlyen para kohe një Shumë Huaje që ka një interes me Normë Fikse Interesi, Huamarrësi, brenda 10 Ditëve Bankare, i paguan KfW-së me kërkesë atë shumë që është e nevojshme për të kompensuar një dëm, shpenzim ose kosto të pësuar nga KfW-ja si rezultat i shlyerjes së parakohshme. (**"Kompensimi i Pagesës së Parakohshme"**). KfW-ja përcakton shumën e kompensimit të shlyerjes së parakohshme dhe ia komunikon Huamarrësit. Me kërkesë të Huamarrësit, KfW-ja do ti japë Huamarrësit një tregues të shumës së tarifës se parapagimit para njoftimit të parevokueshëm të shlyerjes, në pajtim me nenin 6.4 b).

d) *Shumat e kërkueshme*. Huamarrësi paguan gjithashtu shumat e mëposhtme së bashku me shlyerjen e parakohshme, në pajtim me Nenin 6.4 a):

(i) çdo Kompensim të Shlyerjes së parakohshme të kërkueshëm si rezultat i shlyerjes së parakohshme në pajtim me Nenin 6.4 c); dhe

(ii) të gjithë interesin e mbledhur për shumën e shlyer para kohe të Huasë deri në datën e shlyerjes së parakohshme dhe çdo pagese të pashlyer sipas kësaj Marrëveshjeje.

e) *Kompensimi*. Neni 6.2 (*Shumat e padisbursuara të huasë*) zbatohen mutatis mutandis për kompensimin e shlyerjeve të parakohshme.

6.5 *Grafiku i rishikuar i shlyerjes.* Në rast se zbatohet Neni 6.3 ose Neni 6.4 KfW-ja i dërgon Huamarrësit një grafik të rishikuar të shlyerjes që bëhet pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje dhe e zëvendëson grafikun e shlyerjes të vlefshëm deri në atë datë.

7. Llogaritja dhe pagesat në përgjithësi

7.1 *Llogaritja.* Interesi, Tarifa e Zotimit Financiar, kamatëvonesa në pajtim me Nenin 7.5, kompensimi si shumë e plotë për shumat e vonuara në pajtim me Nenin 7.6, kompensimi i mospranimit dhe kompensimi i shlyerjes së parakohshme do të llogariten të gjitha mbi bazën e një viti me 360 ditë dhe muaj me 30 ditë.

7.2 *Data e kërkueshme:* Nëse një pagese që bëhet në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje bie në një datë që nuk është Ditë Bankare, Huamarrësi duhet ta kryejë këtë pagesë në Ditën pasuese Bankare. Nëse Dita pasuese Bankare bie brenda muajit pasues kalendarik, pagesa përkatëse kryhet në Ditën e fundit Bankare të muajit përkatës kalendarik.

7.3 *Numri i Llogarisë, koha e kreditimit.* Huamarrësi lirohet nga detyrimet e pagesës në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje , nëse dhe menjëherë sapo të jenë kredituar shumat përkatëse tek KfW-ja sipas disponimit të lirë pa zbritje në Euro dhe jo më vonë se ora 10:00, para dite, në Frankfurt am Main , Republika Federale e Gjermanisë në llogarinë e KfW-së në Frankfurt am Main , Republika Federale e Gjermanisë, në numrin IBAN DE09 5002 0400 3102 5608 01, me referencë shtesë të datës ("Ref. YYYYMMDD").

7.4 Kundërpretendimet e Huamarrësit. Huamarrësi nuk ka të drejtë të kërkojë ndonjë të drejtë për mbajtjen ose kompensimin e të drejtave të krahasueshme kundrejt detyrimeve të pagesës sipas kësaj Marrëveshjeje, përveç kur këto të drejta njihen nga një vendim përfundimtar ose që nuk kundërshtohen nga KfW-ja.

7.5 *Kamatëvonesa.* Nëse shlyerjet e kësteve përkatëse ose shlyerjet e parakohshme në pajtim me Nenin 6.4 nuk vihen në dispozicion të KfW-së kur bëhen të kërkueshme, KfW-ja, pa njoftim paraprak, mund të vendosë kamatëvonesë me një normë prej 200 pikë bazë në vit mbi normën vjetore të interesit të përcaktuar në nenin 5.1 për periudhën që fillon në datën e kërkueshme dhe që përfundon në datën në të cilën këto pagesa kreditohen tek llogaria e KfW-së e specifikuar në Nenin 7.3. Kjo kamatëvonesë bëhet menjëherë e kërkueshme me kërkesën e parë të KfW-së.

7.6 *Kompensimi me shumë të plotë.* Për shumat e prapambetura (më përjashtim të shlyerjeve të atyre kësteve dhe shlyerjeve të parakohshme që përmenden në Nenin 6.4), KfW-ja, pa njoftim paraprak, mund të kërkojë një kompensim me shumë të plotë me një normë prej 200 pikë bazë në vit mbi Normën vjetore Fikse të Interesit, në pajtim me Nenin 5.1 Kompensimi me shumë të plotë bëhet menjëherë i kërkueshëm pas kërkesës së parë të KfW-së. Huamarrësi është i lirë të provojë që realisht nuk është shkaktuar dëm apo që dëmet nuk janë shkaktuar në shumën e përcaktuar.

7.7 *Kompensimi.* KfW-ja ka të drejtën e kompensimit të pagesave të marra kundrejt pagesave të kërkueshme sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje ose sipas marrëveshjeve të tjera të huasë të lidhura ndërmjet KfW-së dhe Huamarrësit. Për shmangien e dyshimit, kjo do të zbatohet në veçanti në situatën e një vonese apo ngjarjeje të mundshme të vonesës së Huamarrësit.

7.8 *Llogaritjet e kryera nga KfW-ja.* Në mungesë të gabimeve të dukshme, përcaktimet e KfW-së dhe llogaritjet e saj për shumat sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje përbën *provë me shikim të parë (Anscheinsbeweis).*

8. Garancia nga Republika Federale e Gjermanisë

KfW-ja merr garanci për pretendimet e pagesës sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje nga Republika Federale Gjermane para fillimit të disbursimit të parë.

9. Paligjshmëria

Nëse, në çdo juridiksion të zbatueshëm, bëhet e paligjshme për KfW-në për të kryer ndonjë prej detyrimeve të saj të parashikuara nga kjo Marrëveshje ose për të financuar ose mbajtur Huanë, KfW-ja njofton Huamarrësin se:

a) Angazhimi i KfW-së do të anulohet menjëherë; dhe

b) Huamarrësi do të paguajë vetëm shumat e disbursuara dhe që nuk janë shlyer ende në datën e përcaktuar nga KfW-ja në njoftimin e

dërguar për Huamarrësin (jo më parë se ditën e fundit të çdo periudhe lehtësuese të zbatueshme të lejuar me ligj).

10. Kostot dhe Pagesat

10.1 *Ndalimi i zbritjeve dhe ndalesave*. Huamarrësi i kryen të gjitha pagesat sipas kësaj Marrëveshjeje pa asnjë zbritje të tatimeve ose detyrimeve të tjera publike apo kostove të tjera. Në rastin kur Huamarrësi është i detyruar me ligj ose për shkaqe të tjera të kryejë këto zbritje apo ndalesa për pagesat, Huamarrësi paguan çdo shumë shtesë të nevojshme për KfW-në, në mënyrë që shuma neto e mbetur pas ndalimit ose zbritjes të përputhet me shumën që do të ishte e pagueshme sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje, nëse këto zbritje ose ndalesa nuk do të ishin kryer.

10.2 *Kostot*. Huamarrësi mbulon të gjithë kostot dhe shpenzimet që mblidhen në lidhje me disbursimin e Huasë , veçanërisht koston e transfertave dhe dërgesave (duke përfshirë tarifën e konvertimit), si dhe të gjithë koston dhe shpenzimet e bëra në lidhje me mbajtjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

10.3 *Taksat dhe detyrimet e tjera*. Huamarrësi mbulon të gjitha tatimet dhe detyrimet e tjera publike që paguhen jashtë Republikës Federale Gjermane në lidhje me lidhjen dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Nëse KfW jep paradhënie për këto taksa dhe pagesa, Huamarrësi, me kërkesë të KfW-së i transferon ato pa vonesë në llogarinë e përcaktuar në Nenin 7.3 apo në një llogari tjetër të përcaktuar nga KfW-ja.

11. Detyrime të Veçanta

11.1 *Zbatimi i programit dhe informacioni specifik*. Huamarrësi, i përfaqësuar nga Njësia e Koordinimit të Programit, merr masa vetë dhe merr gjithashtu masa që Agjencia e Zbatimit të Projektit:

a) të përgatitë, zbatojë, operojë dhe ruajë Programin në pajtim me praktikat e qëndrueshme financiare dhe teknike, kryesisht në pajtim me standardet mjedisore dhe sociale dhe qëndrueshmërinë në pajtim me konceptin e Programit të rënë dakord ndërmjet Njësisë së Zbatimit të Programit, Agjencive të Zbatimit të Projektit dhe KfW-së;

b) u cakton përgatitjen dhe mbikëqyrjen e ndërtimit për Programin inxhinierëve konsulentë ose konsulentëve të pavarur dhe të kualifikuar dhe zbatimin e Programit shoqërive të kualifikuara;

c) jep kontratat për mallrat dhe shërbimet që financohen nga Huaja (Neni 11.1 b) me ofertim konkurrues ndërkombëtar paraprak;

d) siguron financim të plotë të programit dhe i jep KfW-së, me kërkesë, prova që provojnë se kostoja e papaguar nga kjo Hua është e mbuluar;

e) mban libra dhe regjistra që tregojnë qartë koston e mallrave dhe shërbimeve të kërkuara për Programin dhe që identifikojnë qartësisht mallrat dhe shërbimet e financuara nga kjo Hua;

f) Mundëson që KfW-ja dhe përfaqësuesit e KfW-së të jenë gjithmonë në gjendje të inspektojnë librat dhe regjistrat dhe të gjithë dokumentacionin përkatës për zbatimin dhe operimin e Programit dhe për të vizituar programin dhe instalimet në lidhje me të;

g) i jep KfW-së dhe merr masa që çdo informacion i tille dhe të dhënat e programit dhe progresit të tij të mëtejshëm t'i jepen KfW-së sipas kërkesës së KfW-së;

h) Menjëherë dhe me iniciativen e saj:

(i) i kalon KfW-së çdo pyetje të marrë nga Agjencia e Zbatimit të Projektit nga OECD-ja ose anëtarët e saj sipas të ashtuquajturës "Marrëveshja për Transparencë të Kredive të Palidhura ODA", pas dhënies së kontratave për furnizimet dhe shërbimet që duhet të financohen nga Huaja dhe do të bashkërendojë kërkesën për çdo pyetje të tillë me KfW-në; dhe

(ii) njofton KfW-në për çdo rrethanë që përjashton ose rrezikon seriozisht zbatimin, operimin ose qëllimin e Programit.

i) nuk hyn në ndonjë transaksion ose nuk angazhohet në aktivitete të tjera në lidhje me Programin që do të përbënte një shkelje të embargos që rregullon tregtinë e jashtme ose të ashtuquajturat sanksione financiare të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, Bashkimit Evropian apo Republikës Federale të Gjermanisë.

11.2 *Detajet e zbatimit të Programit. NJKP*, Agjencia e Zbatimit të Projektit dhe KfW përcaktojnë hollësitë që lidhen me nenin 11.1, me anë të Marrëveshjes të Veçantë II, e cila do të kundërfirmoset nga Huamarrësi, i përfaqësuar nga Ministria e Financave.

11.3 *Përputhshmëria.* Huamarrësi siguron që të gjithë personat të cilëve u besojnë përgatitjen dhe zbatimin e Programit, dhënien e kontratave për furnizimet dhe shërbimet që duhet të financohen, dhe kërkimin e shumave të Huasë, të mos kërkojnë, pranojnë, bëjnë, japin apo garantojnë ndonjë premtim për pagesa të paligjshme ose avantazhe të tjera në lidhje me këto detyra.

11.4 *Transporti i mallrave:* Dispozitat e parashikuara në Marrëveshjen Qeveritare zbatohen për transportin e mallrave që duhet të financohen nga Huaja.

11.5 *Renditja Pari passu.* Huamarrësi garanton dhe merr përsipër të përmbushë detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje së paku në të njëjtin rang prioriteti (*pari passu)* me të gjitha detyrimet e pasiguruara ose jo-dytësore ekzistuese dhe në masën e Lejuar nga Ligji, kjo renditje do të sigurohet për të gjitha detyrimet të ardhshme të pasiguruara ose jo-dytësore.

11.6 *Pengu Negativ.* Vetë Huamarrësi nuk do të shkaktojë dhe garanton që Agjencia e Zbatimit të Projektit nuk do të krijojë ose lejojë që të ketë ndonjë " Barrë" për sendet pasurore të programit pa pëlqimin paraprak të KfW-së. **"Barrë"** do të thotë çdo hipotekë, peng, barrë, detyrim apo transferim me anë të garancisë, hipotekës apo interes të garancisë dhe çdo marrëveshje apo marrëveshje tjetër, efekti i së cilës është krijimi i një garancie apo ndonjë të drejte për dhënie prioriteti shlyerjes në lidhje me çdo detyrim të çdo personi.

Ky detyrim nuk zbatohet mbi:

a) Barrën ekzistuese apo për të cilat është rënë dakord kur kjo Marrëveshje është nënshkruar dhe KFW-ja është njoftuar para nënshkrimit të Marrëveshjes;

b) Barrët që janë krijuar në ushtrimin e biznesit sipas rregullave ligjore apo të tjera kontraktuale për të siguruar detyrimet (me përjashtim të detyrimeve të Huasë) ndaj furnizuesit apo ofruesve të tjerë të shërbimeve (p.sh. mbajtjen e të drejtave për titullin në industri dhe barrën ligjore);

c) barra që ekzistonin në kohën kur u mor një pasuri , më kusht që këto barra të hiqen tre muaj pas marrjes.

Nëse Huamarrësi ose çdo AZP jep siguri palës së tretë ose të drejta të tjera që i mundësojnë palës së tretë të ketë preferenca apo pretendime ndaj ndonjërës prej pasurive pronave apo të ardhurave të Programit të Huamarrësit ose AZP-ve, KfW-ja mund japë pëlqimin pasi Huamarrësi apo AZP-ja përkatëse, i siguron KfW-së garancinë (shtesë) në të njëjtën masë që siguron pretendimet e KfW-së ndaj Huamarrësit në pajtim me këtë Marrëveshjeje Huaje.

11.7 *Shitja e sendeve pasurore.* Huamarrësi apo AZP nuk do të shesin ndonjë nga sendet pasurore të Programit deri në momentin që detyrimet e Huamarrësit në këtë Marrëveshje Huaje të jenë shlyer plotësisht.

12. Përfundimi i Marrëveshjes

Arsyet për Përfundim:

12.1 KfW-ja mund të ushtrojë të drejtat e parashikuara sipas Nenit 12.2 (Pasojat ligjore të një Ngjarjeje të Arsyes për Përfundim), nëse ndodh një ngjarje që përbën shkak thelbësor *(wichtiger Grund*). Në veçanti, ngjarjet e mëposhtme përbëjnë shkak material:

a) Huamarrësi nuk përmbush detyrimet ndaj KfW-së për të kryer pagesat kur bëhen të kërkueshme;

b) detyrimet sipas kësaj Marrëveshjeje apo Marrëveshjes së Veçantë II si dhe sipas marrëveshjeve të tjera shtesë në lidhje me këtë Marrëveshje, janë shkelur;

c) kjo Marrëveshje Huaje ose një pjesë e saj pushon së pasuri efekt detyrues për Huamarrësin ose pushon së qeni e ekzekutueshme ndaj Huamarrësit;

d) çdo deklaratë, konfirmim, informacion ose përfaqësim apo garanci e konsideruar nga KfW-ja si thelbësore për dhënien dhe ruajtjen e Huasë rezulton e rreme, e gabuar ose e paplotë;

e) ndodhin rrethana të tjera të jashtëzakonshme që vonojnë ose përjashtojnë përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje;

f) Huamarrësi nëpërmjet NJKP-së ose një Agjencie të Zbatimit të Projektit nuk është në gjendje të vërtetojë që shumat e Huasë janë përdorur për qëllimin e parashikuar;

g) Huamarrësi nuk është në gjendje të paguajë borxhet kur bëhen të kërkueshme; fillimi i bisedimeve me një ose më shumë kreditorë të Huamarrësit për heqjen dorë nga borxhet e mbetura ose për një moratorium apo

zgjidhje apo mosvazhdimin e shërbimit të borxhit.

12.2 *Pasojat ligjore të Ngjarjes së Arsyes për Përfundim*. Nëse një prej rasteve të përmendura në Nenin 12.1 ka ndodhur, KfW-ja mund të ndërpresë menjëherë disbursimin sipas kësaj Marrëveshjeje. Megjithatë, nëse ky rast nuk është zgjidhur brenda një periudhe prej pesë Ditësh Bankare (në rastin e Nenit 12.1 a) ose, në të gjitha rastet e tjera të specifikuara në Nenin 12.1, nuk është zgjidhur brenda një afati të përcaktuar nga KfW-ja që nuk mund të jetë më pak se 30 ditë, KfW-ja mund të zgjidhë këtë Marrëveshje Huaje ose pjesë të saj me pasojën që detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje përfundojnë, dhe KfW-ja mund të kërkojë shlyerje të plotë ose të pjesshme të Shumës së Mbetur të Huasë së bashku me interesin e mbledhur dhe të gjitha shumat e tjera sipas kësaj Marrëveshjeje Huaje. Neni 7.5 dhe 7.6 zbatohen për shumat e përshpejtuara *mutatis mutandis*.

12.3 *Kompensimi për dëmet*. Në rast se kjo Marrëveshje zgjidhet plotësisht ose pjesërisht, Huamarrësi paguan kompensimin për mospranimin sipas Nenit 3.6 (*Kompensimi i Mospranimit*) dhe/ose Kompensimi i Pagimit të Parakohshëm në pajtim me Nenin 6.4 c).

13. Përfaqësimet dhe deklaratat

13.1 *Përfaqësimi i Huamarrësit.* Ministri i Financave dhe ata persona që caktohen prej tij ose saj për KfW-në dhe autorizohen nëpërmjet modeleve të nënshkrimeve të vërtetuara prej tij ose saj e përfaqësojnë huamarrësin në zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Ministri i Transportit dhe Infrastrukturës dhe ata persona që caktohen prej tij ose saj për KfW-në dhe autorizohen nëpërmjet modeleve të nënshkrimeve të vërtetuara prej tij ose saj e përfaqësojnë huamarrësin në zbatimin e këtij Programi dhe kësaj Marrëveshjeje. Fuqia e përfaqësimit nuk skadon derisa të jetë marrë prej KfW-së anulimi shprehimisht nga përfaqësuesi i Huamarrësit të autorizuar për atë kohë.

13.2 *Adresat*. Njoftimet dhe deklarimet në lidhje me këtë Marrëveshje duhet të jetë me shkrim. Ato duhet të dërgohen në origjinal ose – me përjashtim të kërkesave për disbursim – me faks. Secili dhe të gjithë njoftimet ose deklarimet e bëra në lidhje me këtë Marrëveshje Huaje A duhet të dërgohen në adresat e mëposhtme:

Për KfW-në:	KfW Postfach 11 11 41 60046 Frankfurt am Main Germany Faks: +49 69 7431-2944
Për Huamarrësin:	Ministria e Financave Bulevardi, Dëshmorët e Kombit“ Nr. 3 Tiranë, Shqipëri Faks: +355 4222 8494

14. Publikimi dhe transferimi i informacionit që lidhet me Programin

14.1 *Publikimi i informacionit lidhje me Programin nga KfW-ja.* Në përputhje me parimet e pranuara ndërkombëtarisht të transparencës maksimale dhe efikasitetit në bashkëpunimin për zhvillim, KfW publikon informacionin të përzgjedhur (duke përfshirë raportet e vlerësimit) për Shërbimet e Ekspertëve dhe mënyrën sesi financohen gjatë bisedimeve para-kontraktuale, ndërsa marrëveshjet e lidhura me shërbimet është\janë duke u zbatuar në një fazë pas kontraktimit (e referuar si **"Periudha e Plotë "**).

Informacioni publikohet periodikisht në faqen e KfW-së për fushën e saj të biznesit “Banka e Zhvillimit KfW” (http://transparenz.KfW-entwicklungsbank.de/

Publikimi i informacionit (ose nga KfW apo palët e treta në përputhje me Nenin 14.3 më poshtë) për Programin dhe mënyrën e tyre të financimit nuk përfshin dokumentacionin kontraktual ose ndonjë informacion sensitiv financiar apo informacion sensitiv biznesi për palët e përfshira në Program apo në financimin e tij, të tilla si:

a) informacion për të dhëna të brendshme financiare;

b) strategji biznesi;

c) udhëzime dhe raporte të brendshme;

d) të dhëna personale të personave fizikë;

e) vlerësimi i brendshëm i KfW-së për pozicionin financiar të palëve.

14.2 *Transferimi i Informacionit në lidhje me Projektin për Palët e Treta* . KfW-ja ndan informacion të përzgjedhur për Programin dhe mënyrën sesi financohet gjatë të gjithë Periudhës së Plotë me subjektet e mëposhtme,

veçanërisht për të siguruar transparencën dhe efikasitetin:

a) Degët e KfW-së;

b) Republika Federale e Gjermanisë dhe organet, autoritetet, institucionet, Agjencitë apo subjektet kompetente;

c) Organizata të tjera zbatuese të përfshira në bashkëpunimin e zhvillimit dypalësh, veçanërisht Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH;

d) organizatat ndërkombëtare të angazhuara në mbledhjen e të dhënave statistikore, dhe anëtarët e tyre veçanërisht Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim në (OECD) dhe anëtarët e saj.

e) Sekretariatin Shtetëror për Çështjet Ekonomike SECO.

14.3 *Transferimi i informacionit që ka lidhje me Programin tek palët e treta dhe publikimi nga këto palë.* Gjithashtu, Republika Federale e Gjermanisë i ka kërkuar KfW-së të ndajë informacion të përzgjedhur për Programin dhe mënyrës sesi financohet gjatë të gjithë Periudhës së Plotë me subjektet e mëposhtme, të cilat publikojnë artikuj në lidhje me këtë qëllim:

a) Republika Federale e Gjermanisë për qëllime të Iniciativës së Transparencës së Ndihmës Ndërkombëtare http://www.bmz.de/de/was_wir_machen/wege/transparenz-fuer-mehrWirksamkeit/index.html);

b) Tregu & Investimi Gjerman (GTAI) për qëllime të informacionit të tregut (http://www.gtai.de/GTAI/Navigation/DE/trade.FOO);

c) OECD për qëllimin e raportimit të rrjedhës financiare në kuadër të zhvillimit të bashkëpunimit (http://stats.oecd.org/);

d) Instituti Gjerman për Vlerësimin e Zhvillimit (DEval) për qëllime të vlerësimit të zhvillimit të përgjithshëm të bashkëpunimit Gjerman për të garantuar transparencën dhe efiçencën (http://www.deval.org/de/).

e) Sekretariatin Shtetëror për Çështjet Ekonomike SECO (http://www.simap.ch).

14.4 *Transferimi i informacionit që ka lidhje me Programin tek palët e treta (duke përfshirë botimin nga to).* KfW gjithashtu rezervon të drejtën për të transferuar (duke përfshirë edhe për qëllimet e publikimit) informacion në lidhje me shërbimet e ekspertëve dhe sesi financohen gjatë Periudhës së Plotë ndaj palëve të treta, me qëllim mbrojtjen e interesave të ligjshme.

Informacioni nuk transferohet nga KfW-ja tek palët e treta, nëse interesat e ligjshme të Përfituesit në informacionin që nuk transferohet i tejkalon interesat e KFW-së për transferimin e këtij informacioni. Interesat e ligjshme të Përfituesit në veçanti përfshijnë konfidencialitetin e informacioneve sensitive të përmendura në nenin 14.1, i cili përjashtohet nga publikimi.

Gjithashtu, KfW-ja ka të drejtë të transferojë informacion për palët e treta, nëse kjo është e nevojshme për shkak të kërkesave ligjore ose rregulloreve, ose për të mbrojtur pretendimet ose të drejtat e tjera ligjore në gjykatë apo procedime administrative.

15. Dispozita të Përgjithshme

15.1 *Ditë Bankare.* Nëse në këtë Marrëveshje bëhet referencë tek një "**Ditë Bankare**", kjo do të thotë një ditë e ndryshme nga një e shtunë ose e diel, në të cilën bankat tregtare në Frankfurt am Man janë të hapura për biznes të përgjithshëm.

15.2 *Vendi i përmbushjes.* Vendi i përmbushjes së të gjitha detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje është Frankfurt am Main, Republika Federale Gjermane.

15.3 *Pavlefshmëria e pjesshme dhe boshllëqet.* Nëse një dispozitë e kësaj Marrëveshjeje është ose bëhet e pavlefshme, ose nëse ekziston një boshllëk në një prej dispozitave të kësaj Marrëveshjeje Huaje, kjo nuk ndikon në vlefshmërinë e dispozitave të tjera. Palët e kësaj Marrëveshjeje e zëvendësojnë çdo dispozitë të pavlefshme me një dispozitë ligjërisht të vlefshme që i afrohet sa më shumë që të jetë e mundur frymës dhe qëllimit të dispozitës së pavlefshme. Palët plotësojnë çdo boshllëk në dispozita me një dispozitë ligjërisht të vlefshme që i afrohet frymës dhe qëllimit të kësaj Marrëveshjeje.

15.4 *Forma e shkruar.* Ndryshimet dhe shtesat në këtë Marrëveshje Huaje duhet të bëhen me shkrim dhe të gjitha palët duhet të bien dakord. Çdo heqje dorë nga kjo kërkesë e formës me shkrim duhet të deklarohet nga palët me shkrim. Ministri i Financave autorizohet të nënshkruajë çdo ndryshim që duhet të

miratohet nga Këshilli i Ministrave. Ndryshimet e kësaj Marrëveshje që prekin vetëm marrëdhëniet e ligjore midis KfW-së dhe Huamarrësit nuk kërkojnë aprovim nga Agjencitë e Zbatimit të Projektit. Ndryshimet në këtë Marrëveshje që prekin sasinë apo kushtet financiare të Huasë do të kërkojnë ratifikimin nga ana e Kuvendit të Shqipërisë. Të gjitha ndryshimet dhe modifikime të tjera kërkojnë vetëm miratimin e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Çdo zgjatje e afatit për kërkimin e disbursimeve (Neni. 3.2) nuk do të kërkojë miratimin e Këshillit të Ministrave dhe as ratifikimin nga Kuvendi i Shqipërisë.

15.5 *Caktimi*. Huamarrësi nuk mund të caktojë, transferojë, vërë peng apo hipotekë ndaj ndonjë pretendimi nga kjo Marrëveshje Huaje.

15.6 *Ligji i Zbatuar*. Kjo Marrëveshje rregullohet nga Ligji Gjerman.

15.7 *Afati i parashkrimit*. Të gjitha pretendimet e KfW-së sipas kësaj Marrëveshje Huaje A mbarojnë pesë vjet nga fundi i vitit në të cilin kanë lindur këto të drejta dhe në të cilin KfW-ja është vënë në dijeni të rrethanave që përbëjnë këtë pretendim ose mund të ishte vënë në dijeni pa neglizhencë flagrante.

15.8 *Heqja dorë nga imuniteti*. Në masën që huamarrësi, aktualisht ose në të ardhmen, në një juridiksion mund të pretendojë për vete ose sendet e tij pasurore, imunitet nga padia, ekzekutimi, sekuestrimi ose një proces tjetër ligjor dhe në masën që në këtë juridiksion mund të merret për vete ose sendet pasurore një imunitet i tillë, Huamarrësi, në mënyrë të pakthyeshme, bie dakord të mos ngrejë pretendim dhe në mënyrë të pakthyeshme heq dorë nga ky imunitet për pretendime nga dhe në lidhje me këtë Marrëveshje në masën më të gjerë të lejuar nga ligji i këtij juridiksioni.

Huamarrësi nuk heq dorë nga imuniteti në lidhje me:

(i) "mjediset e misionit" të tashme ose të ardhshme sipas përcaktimit në Konventën e Vjenës mbi Marrëdhëniet Diplomatike të nënshkruar në 1961, "mjediset konsullore" të tashme ose të ardhshme sipas përcaktimit në Konventën e Vjenës mbi Marrëdhëniet Konsullore të nënshkruar në 1963 ose ndryshe të përdorura nga një diplomat ose mision diplomatik në Shqipëri ose një agjenci ose instrument i saj;

(ii) çdo pasuri e paluajtshme që përfshihet në dispozitat e Nenit 3, paragrafi 1-3 i ligjit shqiptar nr. 8743, datë 22.02.2001 "Mbi pasuritë e paluajtshme shtetërore";

(iii) çdo fond monetar dhe/ose shumë që është bërë e kërkueshme dhe e paguar në momentin e ekzekutimit për përmbushjen e detyrimeve që ka Republika e Shqipërisë sipas traktateve ndërkombëtare të së drejtës publike, konventave dhe/ose marrëveshjeve të nënshkruara prej saj.

15.9 *Mosmarrëveshjet Ligjore.*

a) Arbitrazhi Të gjitha mosmarrëveshjet që rrjedhin nga ose në lidhje me këtë Marrëveshje huaje zgjidhen ekskluzivisht dhe përfundimisht nga një gjykatë arbitrazhi. Në këtë aspekt, zbatohen sa më poshtë:

(i) Gjykata e arbitrazhit përbëhet nga një ose tre arbitra që emërohen dhe veprojnë në pajtim me Rregullat e Arbitrazhit të Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë (ICC) që ndryshohet herë pas here.

(ii) Gjykimet në arbitrazh kryhen në Frankfurt am Main. Gjykimet zhvillohen në gjuhën angleze.

15.10 *Hyrja në Fuqi.* Kjo Marrëveshje Huaje hyn në fuqi jo më parë se:

a) Huamarrësi të ketë informuar KfW-në me shkrim që Marrëveshja e Huasë është ratifikuar (data e marrjes në KfW); dhe

b) Marrëveshja Qeveritare mbi të cilën është bazuar, ka hyrë në fuqi.

Përgatitur në dy origjinale në gjuhën angleze

Tiranë, _____ 2017

KfW

Nga :	Nga:
Emri:	Emri:
Titulli:	Titulli:

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, i përfaqësuar nga Ministria e Financave

Nga:
Emri:
Titulli:

Aneksi 1

Grafiku i Disbursimit

Grafiku i Disbursimit

Deri në fund të çdo periudhe disbursimi (Data e Përfundimit të Periudhës në pajtim me listën e mëposhtme), Huamarrësi mund të kërkojë disbursim që nuk kalon në total shumën e disbursimeve të përcaktuar në tabelën e mëposhtme:

Për Këstin 1:

Periudha	Data e Përfundimit të Periudhës	Shuma maksimale që mund të disbursohet deri në përfundimin e periudhës (kumulative) (të gjitha shifrat në in EURO)
1	01.01.2018	0.00
2	01.07.2018	3,000,000.00
3	01.01.2019	6,750,000.00
4	01.07.2019	12,750,000.00
5	01.01.2020	14,250,000.00
6	01.01.2023	15,000,000.00

Për Këstin 2:

Periudha	Data e Përfundimit të Periudhës	Shuma maksimale që mund të disbursohet deri në përfundimin e periudhës (kumulative) (të gjitha shifrat në in EURO)
1	01.01.2018	0.00
2	01.07.2018	4,000,000.00
3	01.01.2019	9,000,000.00
4	01.07.2019	17,000,000.00
5	01.01.2020	19,000,000.00
6	01.01.2023	20,000,000.00

DRAFT dated 10.2.17

Aneksi 2

Formati i Opinionit ligjor të Këshilltarit Ligjor të Huamarrësit (Shteti)

Formati i Opinionit Ligjor të Këshilltarit Ligjor të Huamarrësit (Shteti)

Shënim: *Jeni të lutur të ndryshoni përkatësisht "Republika e VENDIT"/"VENDI ".*

[Koka e Letrës së Këshilltarit Ligjor]

KfW-ja
Departamenti [ ]
Në vëmendje të: [ ]
Palmengartenstrasse 5 - 9
Postfach 11 11 41
60325 Frankfurt am Main/Germany

(datë)

Republika Federale e Gjermanisë

Marrëveshje Huaje e datës e lidhur ndërmjet KfW-së dhe [ ] ("Huamarrësit ") për një shumë që nuk i kalon në tërësi .000.000 EURO,--.

Të nderuar Zotërinj,

Unë jam (Ministri i Drejtësisë së) (këshilltari ligjor) (drejtuesi i departamentit juridik të ..... (*jeni të lutur të specifikoni ministrinë ose autoritetin tjetër) Republika e VENDIT*. Unë kam vepruar në këtë cilësi në lidhje me Marrëveshjen e Huasë ("Marrëveshja e Huasë"), të datës ...., të lidhur ndërmjet Huamarrësit, (...) dhe jush mbi një hua që duhet të jepet prej jush tek Huamarrësi në një shumë që nuk kalon në tërësi __000.000,- Euro.

Dokumentet e shqyrtuara

Unë kam shqyrtuar :

1.1 një kopje origjinale autentike të Marrëveshjes së Huasë;

DRAFT datod 16.2.17

1.2 dokumentet kushtetuese të Huamarrësit, veçanërisht:

(a) Kushtetutën e Republikës së *VENDI*, datë _____, të publikuar rregullisht në _____, Nr _____, faqe _____, e ndryshuar;

(b) Ligjin(et) Nr _____ datë _____, të publikuar rregullisht në _____, Nr _____, faqe _____, i ndryshuar *[jeni të lutur të përfshini, sipas rasti , ligjet , (p.sh. ligjet e buxhetit) në lidhje me Huamarrjen nga Republika e VENDIT]*;

(c) _____ *[jeni të lutur t'u referoheni dokumenteve të tjerë, p.sh. dekreteve ose rezolutave të organeve qeveritare ose administrative të VENDIT në përgjithësi ose mbi përfundimin e Marrëveshjes së Huasë]*; dhe

(d) Marrëveshjen e e Bashkëpunimit Financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës së *VENDIT* dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë të datës _____ ("Marrëveshje Bashkëpunimi")

dhe ligje, rregullore, çertifikata, regjistra, regjistrime dhe dokumente të tjera dhe kam kryer ato hetime që i kam konsideruar të nevojshme ose të dëshirueshme për qëllimin e dhënies së këtij opinioni.

2. Opinioni

Për qëllimin e Nenit _____ të Marrëveshjes së Huasë, unë jam i mendimit së sipas ligjeve të republikës së *VENDIT* të kësaj datë:

2.1 Në pajtim me Nenin _____ të Kushtetutës / Neni _____ të Ligjit mbi _____ *[jeni të lutur të specifikoni sipas rastit]* Huamarrësi ka të drejtë të lidhë Marrëveshjen e Huasë dhe ka marrë të gjitha masat e nevojshme për të autorizuar nënshkrimin, dorëzimin dhe përmbushjen e Marrëveshjes së Huasë, veçanërisht nëpërmjet :

(a) Ligjet(eve) Nr. _____ datë _____ të parlamentit të Republikës së *VENDIT* , që ratifikon Marrëveshjen e Huasë / aprovon nënshkrimin, dorëzimin dhe përmbushjen e Marrëveshjes së Huasë nga Huamarrësi / _____ *[jeni të lutur të plotësoni sipas rastit]*;

(b) Vendimin(et) Nr. _____ datë _____ të Kabinetit të Ministrave/ të komitetit të huave shtetërore / _____ *[jeni të lutur të plotësoni organet qeveritare ose administrative të VENDIT, sipas rastit]*;

(c) _____ [jeni të lutur t'u referoheni rezolutave, vendimeve etj.].

2.2 Znj./Z. _____ (dhe Znj./Z. _____) është (janë) të autorizuar nga _____ *[p.sh ligjërisht për shkak të pozicionit të saj/ tij (si Ministër i _____/ si _____), me vendim*

qeverie, _____, me prokurë _____ datë _____, etj.] për të nënshkruar vetëm / bashkërisht Marrëveshjen e Huasë në emër të Huamarrësit. Marrëveshja e Huasë e nënshkruar nga Znj./Z. _____ dhe Znj ./Z. _____) është nënshkruar rregullisht në emër të Huamarrësit dhe përbën një detyrim ligjërisht detyrues të Huamarrësit të ekzekutueshëm ndaj tij ligjërisht, në pajtim me kushtet e tij.

*[**Alternativa 1** për Seksionin 2.3 që duhet të përdoret, nëse janë bashkë me dokumentet e specifikuara në Seksionin 2.1 dhe 2.2, autorizime të caktuara zyrtare etj, të cilat duhet të merren sipas ligjeve të Republikës së VENDIT:]*

2.3 Për nënshkrimin dhe përmbushjen e Marrëveshjes së Huasë nga huamarrësi (duke përfshirë pa kufizim përftimin dhe transferimin tek KfW-ja të të gjitha shumave të kërkueshme në monedhat e specifikuara), aprovimet, autorizimet, licencat, regjistrimet dhe/ose pëlqimet e nevojshme zyrtare janë marrë dhe janë plotësisht në fuqi:

(a) Aprovimi i _____ [Bankës Qendrore / Bankës Kombëtare / _____], datë _____, Nr. _____;

(b) Pëlqimi i _____ [Ministër / Ministria e _____], datë _____, Nr. _____; dhe

(c) _____ *[jeni të lutur të rendisni çdo Autorizim licence dhe / ose aprovim zyrtar].*

Asnjë autorizim, pëlqim, licencë, regjistrim dhe/ose aprovim zyrtar tjetër i një autoriteti ose agjencie qeveritare (duke përfshirë Bankën Qendrore/kombëtare të Republikës së (*VENDIT*) ose gjykatë nuk kërkohet dhe nuk është e këshillueshme në lidhje me nënshkrimin dhe përmbushjen e Marrëveshjes së Huasë nga huamarrësi (duke përfshirë pa kufizim marrjen dhe transferimin tek KfW-ja të të gjitha shumave në monedhat e specifikuara) dhe vlefshmërinë dhe ekzekutueshmërinë e detyrimeve të Huamarrësit sipas Marrëveshjes së Huasë,

ose

*[**Alternativa** 2 për Seksionin 2.3 që përdoret vetëm si shtesë e dokumenteve të specifikuara në Seksionin 2.1 dhe 2.2, asnjë autorizim zyrtar nuk duhet të merret sipas ligjeve të Republikës së VENDIT:]*

2.3 Asnjë autorizim, pëlqim, licencë, regjistrim dhe/ose aprovim zyrtar tjetër i një autoriteti ose agjencie qeveritare (duke përfshirë Bankën Qendrore/kombëtare të Republikës së VENDIT) ose gjykatë nuk kërkohet dhe nuk është e këshillueshme në lidhje me nënshkrimin dhe përmbushjen e Marrëveshjes së Huasë nga huamarrësi (duke përfshirë pa kufizim marrjen dhe transferimin tek KfW-ja të të gjitha shumave në monedhat e specifikuara)

dhe vlefshmërinë dhe ekzekutueshmërinë e detyrimeve të Huamarrësit sipas Marrëveshjes së Huasë

2.4 Asnjë taksë pulle apo taksë apo detyrim i ngjashëm nuk duhet të paguhet në lidhje me vlefshmërinë ose ekzekutueshmërinë e Marrëveshjes së Huasë

2.5 Zgjedhja e ligjit gjerman për të rregulluar Marrëveshjen e Huasë dhe paraqitja për arbitrazh në pajtim me Nenin _____ të Marrëveshjes së Huasë janë të vlefshme dhe detyruese. Vendimet e arbitrazhit ndaj Huamarrësit janë të njohura dhe të ekzekutueshme në Republikën e *VENDIT* në pajtim me rregullat e mëposhtëm: ... *(jeni të lutur të plotësoni traktatin e zbatueshëm (sipas rastit), p.sh., Konventa e Nju Jorkut e vitit 1958, dhe/ose parimet bazë në lidhje me njohjen dhe ekzekutimin e vendimeve të arbitrazhit në VEND)*.

2.6 Gjykatat e Republikës së *VENDIT* kanë të drejtë të japin vendime të përcaktuara në monedhën ose monedhat e specifikuara në Marrëveshjen e Huasë.

2.7 Huamarrja nga Huamarrësi sipas Marrëveshjes së Huasë dhe nënshkrimi dhe përmbushja nga Huamarrësi i Marrëveshjes së Huasë përbëjnë veprime juridike private dhe tregtare dhe jo veprime juridike qeveritare ose publike. As Huamarrësi dhe as pasuria e tij nuk ka të drejtën e imunitetit nga arbitrazhi, padia, ekzekutimi, sekuestrimi ose procese të tjera ligjore.

2.8 Marrëveshja Bashkëpunimit është në fuqi të plotë sipas kushtetutës dhe ligjeve të Republikës së *VENDIT*. (Në pajtim me Nenin 3 të Marrëveshjes së Bashkëpunimit) (Nëse Marrëveshja e Bashkëpunimit nuk ka hyrë në fuqi por nuk ekziston një marrëveshje e tatimit të dyfishtë). Në pajtim me _____ _____ *(jeni të lutur të specifikoni traktatin ose ligjet dhe rregulloret e zbatueshme)* / Huamarrësit nuk i kërkohet të kryejë ndonjë zbritje ose ndalim nga ndonjë pagesë që Huamarrësi duhet të bëjë sipas Marrëveshjes së Huasë dhe nëse kjo zbritje ose ndalesë duhet të vendoset më vonë, dispozitat e Nenit _____ të Marrëveshjes së huasë zbatohen për t'i kërkuar huamarrësit të zhdëmtojë KfW-në sipas rregullave.

2.9 KfW-ja nuk është dhe nuk konsiderohet të jetë rezidente, me banim, të zhvillojë biznes ose t'i nënshtrohet tatimit në Republikën e *VENDIT* për shkak vetëm të nënshkrimit, përmbushjes ose ekzekutimit të Marrëveshjes së Huasë. Nuk është e nevojshme ose e kështillueshme që KfW-ja të jetë e liçencuar, e kualifikuar ose me të drejta të tjera të zhvillojë biznes ose që KfW-ja të emërojë agjentë ose përfaqësues në Republikën e *VENDIT*.

Për pasojë, detyrimet e Huamarrësit sipas Marrëveshjes së Huasë përbëjnë detyrime ligjore, të vlefshme dhe detyruese të drejtpërdrejta dhe pa kushte të Huamarrësit, të cilat janë të ekzekutueshme ndaj Huamarrësit në pajtim me kushtet e tyre përkatëse.

Ky opinion ligjor është i kufizuar për ligjet e Republikës së *VENDIT*.

_____, _____
(Vendi) (Data)

[Nënshkrimi]
Emri: _____

Bashkëlidhur:
Shënim: Jeni të lutur të bashkëlidhni fotokopje të vërtetuara të dokumenteve dhe dispozitave ligjore të përmendura më sipër (në lidhje me ligjet me tekst të gjatë ose Kushtetutën e Republikës *së VENDIT*, një kopje e dispozitave përkatëse do të ishte e mjaftueshme) dhe t'i jepni KfW-së një përkthim të vërtetuar në anglisht ose gjermanisht të secilit prej dokumenteve të mësipërme, nëse ky dokument nuk është lëshuar në anglisht ose gjermanisht si gjuhë zyrtare, përveç rasteve kur KfW jep pëlqimin dhe për një gjuhë tjetër.

LIGJ
Nr. 88/2017

PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR 2016, PËR PROJEKTIN "FONDI ARSIMOR PËR FORMIMIN PROFESIONAL DHE PUNËSIMIN"

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunim financiar 2016, për projektin "Fondi arsimor për formimin profesional dhe punësimin", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar në datën 4.5.2017

Shpallur me dekretin nr. 10342, datë 18.5.2017 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË PËR BASHKËPUNIM FINANCIAR 2016 PËR PROJEKTIN "FONDI ARSIMOR PËR FORMIMIN PROFESIONAL DHE PUNËSIMIN"

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë Dhe Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë

në frymën e marrëdhënieve ekzistuese miqësore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Federale të Gjermanisë,

duke u nisur nga dëshira për t'i forcuar dhe thelluar këto marrëdhënie miqësore nëpërmjet Bashkëpunimit Financiar si partnerë,

të ndërgjegjshme se ruajtja e këtyre marrëdhënieve përbën bazën e kësaj marrëveshjeje,

me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë,

duke iu referuar protokollit të bisedimeve ndërqeveritare të datës 12 korrik 2016 dhe premtimit të Ambasadës së Republikës Federale të Gjermanisë datë 29 nëntor 2016 (nota verbale nr. 349/2016)

kanë rënë dakord si vijon:

Neni 1

1. Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë ose huamarrësve të tjerë, të cilët do të zgjidhen bashkërisht nga të dy Qeveritë, të marrin nga Kreditanstalt für Wiederaufbau (KfW) shumën e financimit në vlerë të përgjithshme deri në 4 500 000 euro (me fjalë: katër milionë e pesëqind mijë euro), për projektin "Fondi arsimor për formimin profesional dhe punësimin" nëse nga shqyrtimi përkatës ka rezultuar se projekti vlen për t'u mbështetur;

2. Projekti i përmendur në paragrafin 1 mund të zëvendësohet me projekte të tjera, nëse për këtë bien dakord Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë dhe Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë.

3. Në rast se Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë në një kohë të mëvonshme i jep mundësi Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë të marrë nga Kreditanstalt für Wiederaufbau hua shuma të tjera financimi për përgatitjen e projektit të përmendur në paragrafin 1 apo për masa të nevojshme shoqëruese për zbatimin dhe mbikqyrjen e projektit të përmendur në paragrafin 1, gjen zbatim kjo marrëveshje.

Neni 2

1. Përdorimi i shumës së përmendur në nenin 1, paragrafi 1, kushtet me të cilat vihet në dispozicion ajo, si dhe procedura e dhënies së porosisë përcaktohen në kontratat që do të lidhen midis Kreditanstalt für Wiederaufbau dhe të marrësve të shumës së financimit, të cilat u nënshtrohen dispozitave ligjore që janë në fuqi në Republikën Federale të Gjermanisë.

2. Premtimi i shumës së përmendur në nenin 1, paragrafi 1, do të zhvlerësohet, në rast se kontratat përkatëse të financimit nuk lidhen brenda një afati prej gjatë vitesh pas vitit të premtimit. Afati për shumën e përmendur mbaron më 31 dhjetor 2022.

3. Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në rastet kur ai vetë nuk është marrës i shumës së financimit, do të garantojë ndaj Kreditanstalt für Wiederaufbau të gjitha pagesat me euro për shlyerjen e borxheve të marrësve të shumës së financimit në bazë të kontratave, të cilat do të lidhen sipas paragrafit 1.

Neni 3

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e përjashton KfW-në nga të gjitha tatimet dhe taksat direkte, që lindin në Republikën e Shqipërisë në kontekstin e lidhjes dhe zbatimit të kontratave të përmendura në nenin 2 paragrafi 1. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar si dhe taksa e tatime të ngjashme indirekte, që lindin në këtë kontekst, mbarten nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Krahas kësaj Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e përjashton KfW-në nga të gjitha taksat dhe tatimet e tjera publike.

Neni 4

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë e lë në gjykimin e pasagjerëve dhe furnizuesve të zgjedhin lirisht mes ndërmarrjeve transportuese për transportimin e personave dhe të mallrave në rrugë detare, tokësore dhe ajrore, transport ky që rezulton nga dhënia e shumave të financimit, si dhe nuk merr asnjë masë, e cila përjashton ose vështirëson pjesëmarrjen me të drejta të barabarta të ndërmarrjeve transportuese me seli në Republikën Federale të Gjermanisë, dhe nxjerr sipas rastit lejet e nevojshme për pjesëmarrjen e këtyre ndërmarrjeve transportuese.

Neni 5

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në ditën, kur Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë i

njofton Qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, se janë përmbushur kushtet brendashtetërore për hyrjen në fuqi. Përcaktuese është dita e marrjes së njoftimit.

2. Mosmarrëveshjet lidhur me interpretimin apo zbatimin e kësaj marrëveshjeje do të zgjidhen në dakordësi mes palëve kontraktuese përmes bisedave apo bisedimeve përkatëse.

3. Regjistrimi i kësaj marrëveshjeve pranë Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara sipas nenit 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara realizohet menjëherë pas hyrjes së saj në fuqi prej Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Pala tjetër kontraktuese njoftohet rreth regjistrimit të kryer përmes përcjelljes së numrit të regjistrit të Kombeve të Bashkuara, sapo ky numër të jetë konfirmuar prej Sekretariatit të Kombeve të Bashkuara.

Bërë në Tiranë më në dy origjinalë, secili në gjuhën gjermane dhe shqipe, duke pasur të dy tekstet fuqi të barabartë.

Për Këshillin e Ministrave të Republikës së Shqipërisë	Për Qeverinë e Republikës Federale të Gjermanisë

VENDIM
Nr. 428, datë 17.5.2017

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 592, DATË 5.9.2007, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E PERSONALITETEVE TË TJERA TË LARTA SHTETËRORE TË VENDIT, QË DO TË RUHEN DHE MBROHEN NGA GARDA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË EDHE PAS LIRIMIT NGA FUNKSIONI"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 8869, datë 22.5.2003, "Për Gardën e Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 2 e vendimit nr. 592, datë 5.9.2007, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë:

"2. Personalitetet e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, ruhen dhe mbrohen me oficer e nënoficer shoqërues edhe 2 (dy) vjet pas lirimit nga funksioni.".

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Garda e Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM
Nr. 429, datë 17.5.2017

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 1719, DATË 17.12.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE TË ANKANDIT PUBLIK", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 45, të ligjit nr. 9874, datë 14.2.2008, "Për ankandin publik", të ndryshuar, me propozim të ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në rregullat e ankandit publik, miratuar me vendimin nr. 1719, datë 17.12.2008, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat, si më poshtë vijon:

1. Pas paragrafit të fundit të pikës 4, të kreut IV, "Llojet dhe përzgjedhja e procedurës", shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"- Procedura me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit të ankandit.".

2. Pas pikës 4.3, të kreut IV, "Llojet dhe përzgjedhja e procedurës", shtohet pika 4.4, me këtë përmbajtje:

"4.4 Procedura me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit të ankandit:

a) Kjo procedurë përdoret vetëm në rastet e parashikuara në nenin 20/1, të ligjit nr. 9874, datë 14.2.2008, "Për ankandin publik", të ndryshuar.

b) Autoriteti shitës përdor procedurën me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit të ankandit, për mallrat e konfiskuara dhe të administruara nga Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit, natyra e të cilëve nuk lejon zbatimin e afateve të përcaktuara në nenin 28, të ligjit nr. 9874, datë 14.2.2008, "Për ankandin publik", të ndryshuar, dhe përcaktimin e çmimit të plotë, në veçanti:

- të shitjes së gjësë së gjallë;

- të shitjes së mallrave të konfiskuara (fruta, perime, bulmet, mish dhe çdo mall i këtij lloji) që ndryshojnë natyrë në një kohë relativisht të shkurtër apo që mund të jenë në prag skadence dhe që është i domosdoshëm tjetërsimi i tyre.

c) Urdhri për ankand, siç parashikohet në kreun V, shkronja "ç", e pikës 5, e këtyre rregullave, përcakton edhe arsyet e përdorimit të kësaj procedure.

ç) Afati kohor minimal, për dorëzimin e ofertave në këtë procedurë, është 3 ditë nga data në të cilën është dërguar ftesa për ofertë kandidatëve.".

3. Në shkronjën "c", të pikës 5.3, të kreut V, "Zhvillimi i procedurave", pas fjalëve "...10 ditë...", shtohen fjalët "...ndërsa për procedurën me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit të ankandit, nuk duhet të kalojë 3 ditë.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

VENDIM
Nr. 431, datë 17.5.2017

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 418, DATË 27.6.2012, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KËSHILLAVE, BORDEVE OSE KOMISIONEVE TË NJËSIVE TË QEVERISJES QENDRORE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në lidhjen nr. 1, të përmendur në pikën 3, të vendimit nr. 418, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Në ndarjen "Ministria e Financave", emërtesa "Këshilli i Menaxhimit të Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës" shfuqizohet.

b) Pas ndarjes "Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara" shtohet ndarja "Kryeministria 'Këshilli Mbikëqyrës i Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës'" dhe në ndarjen "Ministria e Kulturës" shtohet nënndarja "Këshilli Kombëtar për të Drejtën e Autorit" sipas përcaktimeve të paraqitura në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare përballohen nga buxheti i miratuar për institucionet e përmendura në këtë vendim.

3. Ngarkohen njësitë e qeverisjes qendrore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

Tabela

Institucioni Buxhetor	Emertesa e Bordit/Keshilli/Komisionit	Numri maksimal i pagesave në një vit	Përbërja		Shpërblim kryetari (Lekë)	Shpërblim anëtari (Lekë)
			Kryetari	Nr. i Anëtareve		
Ministria e Kulturës	Këshilli Kombëtar për të Drejtën e Autorit	9	1	4	5,000	5,000
Kryeministria	Këshilli Mbikqyrës i Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës	10	1	2	15,000	10,000

VENDIM
Nr. 432, datë 17.5.2017

PËR RISHPËRNDARJE FONDESH, NGA MINISTRIA E ZHVILLIMIT URBAN NË AGJENCINË PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK RAJONAL, PËR GRANTIN "NËNPROGRAMI I MBËSHTETJES FINANCIARE PËR NDËRMARRJET MIKRO, TË VOGLA DHE TË MESME (NMVM)", MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 14, DATË 21.3.2017, TË KOMITETIT PËR ZHVILLIMIN E RAJONEVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 18, të ligjit nr. 130/2016, "Për buxhetin e vitit 2017", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondet buxhetore, të miratuara në buxhetin e vitit 2017 për Ministrinë e Zhvillimit Urban, në programin "Infrastruktura vendore dhe rajonale", rishpërndahen për Agjencinë për Zhvillimin Ekonomik Rajonal, në zbatim të vendimit nr. 14, datë 21.3.2017, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, "Për miratimin e financimit për grantin "Nënprogrami i mbështetjes financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM)"", të programit "Mbështetje për ekonominë", si dhe të kalendarit me datën e fillimit të aplikimeve, për vitin 2017", sipas tabelës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban, Ministria e Financave dhe Agjencia për Zhvillimin Ekonomik Rajonal për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

Ministria e Zhvillimit Urban
Shpërndarja e fondeve buxhetore për Programin "Mbështetje për Ekonominë"

në lekë

EQ	Gr	Kodi inst.	Emërtimi i Institucionit	Kap.	Programi	Llog. ekon.	Kodi i Thesarit	Kodi i projektit	Shuma	Emërtimi i projektit të investimit
PAKËSOHET										
001	94	1094001	Aparati I MZHU	01	06210	2310000	3535	M940115	400,000,000	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve
Totali i pakësimeve									**400,000,000**	
SHTOHET										
01	87	1087021	AZHER	01	01150	2310000	3535	Kod I ri	400,000,000	Mbështetje financiare për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme
Totali i shtesave									**400,000,000**	

VENDIM
Nr. 433, datë 17.5.2017

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMET NR. 1481, DATË 12.11.2008; NR. 100, DATË 27.1.2009; NR. 167, DATË 19.2.2009; NR. 286, DATË 18.3.2009; NR. 450, DATË 6.5.2009; NR. 611, DATË 11.6.2009; NR. 677, DATË 18.6.2009; NR. 706, DATË 23.6.2009; NR. 805, DATË 22.7.2009; NR. 1038, DATË 14.10.2009; NR. 1283, DATË 23.12.2009; NR. 125, DATË 17.2.2010; NR. 404, DATË 26.5.2010; NR. 549, DATË 7.7.2010; NR. 646, DATË 28.7.2010; NR. 118, DATË 17.2.2011; NR. 822, DATË 23.11.2011; NR. 513, DATË 1.8.2012; NR. 61, DATË 23.1.2013; NR. 345, DATË 24.4.2013; NR. 490, DATË 18.6.2013; NR. 501, DATË 10.6.2015; NR. 279, DATË 1.4.2015; NR. 615, DATË 7.7.2015; NR. 882, DATË 30.10.2015; NR. 1094, DATË 28.12.2015; NR. 871, DATË 14.12.2016, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, PËR MIRATIMIN E KALIMIT TË PRONËSISË SË DISA PARCELAVE NDËRTIMORE, NË FAVOR TË POSEDUESVE TË OBJEKTEVE INFORMALE, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 17, të ligjit nr. 9482, datë 3.4.2006, "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, të shkronjës "ç", të nenit 4, të ligjit nr. 7980, datë 27.7.1995, "Për shitblerjen e trojeve", të ndryshuar, dhe të nenit 163, të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994, "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimet nr. 1481, datë 12.11.2008; nr. 100, datë 27.1.2009; nr. 167, datë 19.2.2009; nr. 286, datë 18.3.2009; nr. 450, datë 6.5.2009; nr. 611, datë 11.6.2009; nr. 677, datë 18.6.2009; nr. 706, datë 23.6.2009; nr. 805, datë 22.7.2009; nr. 1038, datë 14.10.2009; nr. 1283, datë 23.12.2009; nr. 125, datë 17.2.2010; nr. 404, datë 26.5.2010; nr. 549, datë 7.7.2010; nr. 646, datë 28.7.2010; nr. 118, datë 17.2.2011; nr. 822, datë 23.11.2011; nr. 513, datë 1.8.2012; nr. 61, datë 23.1.2013; nr. 345, datë 24.4.2013; nr. 490, datë 18.6.2013; nr. 501, datë 10.6.2015; nr. 279, datë 1.4.2015; nr. 615, datë 7.7.2015; nr. 882, datë 30.10.2015; nr. 1094, datë 28.12.2015; nr. 871, datë 14.12.2016, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë për parcelën ndërtimore me nr. pasurie 11/1160, në Drejtorinë e ALUIZNI-t Durrës, të jenë sipas lidhjes A, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 11/72, 5/10, 155/249, 155/245, në drejtoritë e ALUIZNI-t Elbasan, Tirana Veri dhe Durrës, të jenë sipas lidhjes C, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë për parcelën ndërtimore me nr. pasurie 152/123, në Drejtorinë e ALUIZNI-t Durrës, të jenë sipas lidhjes D, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 1/376, 12/183, 150/163, 15/51, në drejtoritë e ALUIZNI-t Tirana Jug dhe Durrës, të jenë sipas lidhjes E, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

5. Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 3/535, 3/516, 4/411, 11/318, 16/372, në drejtoritë e ALUIZNI-t Tirana Jug, Durrës dhe Elbasan, të jenë sipas lidhjes F, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 9/268, 9/91, 9/291, 7/688, 9/191, 9/91, 9/286, 12/45, 3/659, në drejtoritë e ALUIZNI-t Elbasan, Tirana Jug dhe Tirana Veri, të jenë sipas lidhjes G, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

7. Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 6/190, 6/346, 5/489, 5/488, 7/604, në drejtoritë e ALUIZNI-t Elbasan, Tirana Jug dhe Tirana Veri, të jenë sipas lidhjes H, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

8. Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë, për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 6/303, 400/592, 15/590, 13/636, 400/225, 8/593, 2/700, në Drejtorinë e ALUIZNI-t Tirana Jug, të jenë sipas

lidhjes I, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

9. Gjenealitetet e poseduesve të objektit informal dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 11/580, 11/590, 1/451, 7/350, 9/396, 8/381, 11/316, 90/12, 91/4, 2/33, në drejtoritë e ALUIZNI-t Tirana Jug, Fier, Elbasan dhe Durrës, të jenë sipas lidhjes J, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

10. Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 1/370, 7/369, 436/154, 1/189, 7/414, 42/82, 5/1104, në drejtoritë e ALUIZNI-t Tirana Jug, Tirana Veri dhe Durrës, të jenë sipas lidhjes K, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

11. Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 60/86, 5/552, 136/241, në Drejtorinë e ALUIZNI-t Tirana Jug, të jenë sipas lidhjes M, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

12. Gjenealitetet e poseduesit të objektit informal dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 30/125, 7/448, 236/151, 1/657, 4/230, 3/205, në drejtoritë e ALUIZNI-t Elbasan, Tirana Jug, Tirana Veri, Tirana 2 dhe Durrës, të jenë sipas lidhjes N, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

13. Gjenealitetet e poseduesit të objektit informal dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 5/360, 3/272, 5/738, 2/95, në drejtoritë e ALUIZNI-t Tirana 2, Tirana Jug dhe Elbasan, të jenë sipas lidhjes P, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

14. Gjenealitetet e poseduesve të objekteve informale dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 5/234, 80/901, 5/824, 5/835, 8/715, 8/305, 15/420, 10/219, 10/220, në drejtoritë e ALUIZNI-t Elbasan, Tirana Jug, Fier dhe Durrës, të jenë sipas lidhjes Q, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

15. Gjenealitetet e poseduesit të objektit informal dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 7/436, 80/1181, 8/629, 9/1607/1, në drejtoritë e ALUIZNI-t Tirana Jug dhe Tirana Veri, të jenë sipas lidhjes R, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

16. Gjenealitetet e poseduesit të objektit informal dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 14/143, 15/217, 1/682, në drejtoritë e ALUIZNI-t Elbasan dhe Durrës, të jenë sipas lidhjes S, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

17. Gjenealitetet e poseduesit të objektit informal dhe të dhënat e pasurisë për parcelën ndërtimore me nr. pasurie 4/394, në Drejtorinë e ALUIZNI-t Tirana 2, të jenë sipas lidhjes U, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

18. Gjenealitetet e poseduesit të objektit informal dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 1/464, 3/388, 3/391, në Drejtorinë e ALUIZNI-t Tirana 2, të jenë sipas lidhjes V, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

19. Gjenealitetet e poseduesit të objektit informal dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 11/629, 1/421, 6/28, në drejtoritë e ALUIZNI-t Shkodër, Tirana 2 dhe Dibër, të jenë sipas lidhjes Z, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

20. Gjenealitetet e poseduesit të objektit informal dhe të dhënat e pasurisë për parcelën ndërtimore me nr. pasurie 4/196, në Drejtorinë e ALUIZNI-t Gjirokastër, të jenë sipas lidhjes AA, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

21. Gjenealitetet e poseduesit të objektit informal dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 2/482, 2/484, në Drejtorinë e ALUIZNI-t Elbasan, të jenë sipas lidhjes AC, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

22. Gjenealitetet e poseduesit të objektit informal dhe të dhënat e pasurisë për parcelën ndërtimore me nr. pasurie 8/134, në Drejtorinë e ALUIZNI-t Kukës, të jenë sipas lidhjes AG, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

23. Gjenealitetet e poseduesit të objektit informal dhe të dhënat e pasurisë për parcelën ndërtimore me nr. pasurie 2/4, në Drejtorinë e ALUIZNI-t Durrës, të jetë sipas lidhjes AI, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

24. Gjenealitetet e poseduesit të objektit informal dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 28/162, 42/251/1, 30/236, në drejtoritë e ALUIZNI-t Kukës dhe Durrës, të jenë sipas lidhjes AK, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

25. Gjenealitetet e poseduesit të objektit informal dhe të dhënat e pasurisë për parcelën ndërtimore me nr. pasurie 5/551, në Drejtorinë e ALUIZNI-t Tirana 2, të jenë sipas lidhjes AN, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

26. Gjenealitetet e poseduesit të objektit informal dhe të dhënat e pasurisë për parcelën ndërtimore me nr. pasurie 6/800, në Drejtorinë e

ALUIZNI-t Tirana 2, të jenë sipas lidhjes AP, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

27. Gjenealitetet e poseduesit të objektit informal dhe të dhënat e pasurisë për parcelat ndërtimore me nr. pasurie 3/65/1, 30/330, 7/202/1, në drejtoritë e ALUIZNI-t Durrës dhe Elbasan, të jenë sipas lidhjes AQ, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

REPUBLIKA E SHQIPERISË
Ministria e Zhvillimit Urban
Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale

LISTA EMËRORE SIPAS DREJTORIVE RAJONALE PËR KORIGJIM

LIDHJA A

NR.RENDOR	DREJTORIA	KORIGJIMI	EMER	ATESI	MBIEMER	NR. PROTOKOLLI I VETEDEKLARIMIT PER LEGALIZIM	ZONA KADASTRALE	NUMRI I PASURISE	SIPERFAQJA E PARCELES NDERTIMORE PER KALIM PRONESIE (m²)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	11
1	DURRES	ishte	BLENARD	DYLBER	ZOGU	9327	8513	11/160	394
		behet	BLENARD	DYLBER	ZOGU	9327		11/160	446

LIDHJA C

NR.RENDOR	DREJTORIA	KORIGJIMI	EMER	ATESI	MBIEMER	NR. PROTOKOLLI I VETEDEKLARIMIT PER LEGALIZIM	ZONA KADASTRALE	NUMRI I PASURISE	SIPERFAQJA E PARCELES NDERTIMORE PER KALIM PRONESIE (m²)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	11
2	ELBASAN	Ishte	XHEVDET	XHEMAL	MUSTA	948	8526	11/72	496.3
		Behet	XHEVDET	XHEMAL	MUSTA	948	8526	11/72	496.3
			VANGJEL	XHEVDET	MUSTA				
3	TIRANA VERI	ISHTE	NEXHAT	QAMIL	DUPI	233	8340	5/10	228
		BEHET	LIRIM	NEXHAT	DUPI	233	8340	5/10	234.7
4	DURRES	ishte	BRAHIM	ISMAIL	LATIFI	2065	8517	155/249	175.51
		behet	BRAHIM	ISMAIL	LATIFI	2065	8517	155/249	500
5	DURRES	ishte	NESIM	BRAHIM	LATIFI	2066	8517	155/245	348.48
		behet	NESIM	BRAHIM	LATIFI	2066	8517	155/245	500

LIDHJA D

NR.RENDOR	DREJTORIA	KORIGJIMI	EMER	ATESI	MBIEMER	NR. PROTOKOLLI I VETEDEKLARIMIT PER LEGALIZIM	ZONA KADASTRALE	NUMRI I PASURISE	SIPERFAQJA E PARCELES NDERTIMORE PER KALIM PRONESIE (m²)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	11
6	DURRES	ISHTE	ASLLAN	SHAQIR	MUCA	8240	8517	152/123	377.5
		BEHET	ASLLAN	SHAQIR	MUCA	8240	8517	152/123	498

LIDHJA E

NR.RENDOR	DREJTORIA	KORIGJIMI	EMER	ATESI	MBIEMER	NR. PROTOKOLLI I VETEDEKLARIMIT PER LEGALIZIM	ZONA KADASTRALE	NUMRI I PASURISE	SIPERFAQJA E PARCELES NDERTIMORE PER KALIM PRONESIE (m²)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	11
7	TIRANA JUG	Ishte	BEHAR	MUHAMET	ZEQOLLARI	2210	8240	1/376	310.5
		Behet	MUHAMET	RIZA	ZEQOLLARI	2211/2210	3321	1/377	542.7
			BEHAR	MUHAMET	ZEQOLLARI				
8	DURRES	ishte	ALI	IZET	KUME	1324	8513	12/183	315
		behet	ALI	IZET	KUME	1324		12/183	412
9	DURRES	ishte	SADIK	ELEZ	RUCI	4506	8517	150/163	308.59
		behet	SADIK	ELEZ	RUCI	4506		150/163	443
10	DURRES	ISHTE	ISLAM	IBRAHIM	BOSHNJAKU	7883	8511	15/51	222
		BEHET	ISLAM	IBRAHIM	BOSHNJAKU	7883	8511	15/51	394

LIDHJA F

NR.RENDOR	DREJTORIA	KORIGJIMI	EMER	ATESI	MBIEMER	NR. PROTOKOLLI I VETEDEKLARIMIT PER LEGALIZIM	ZONA KADASTRALE	NUMRI I PASURISE	SIPERFAQJA E PARCELES NDERTIMORE PER KALIM PRONESIE (m²)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	11
11	TIRANA JUG	Ishte	REXHEP	SKENDER	TOCILLA	858	8190	3/535	499.5
			SHEFKI	REXHEP	TOCILLA				
		Behet	SKENDER	SHEFKI	TOCILLA	858	8190	3/535	530
			SHEFKI	REXHEP	TOCILLA				
12	TIRANA JUG	Ishte	SEFER	XHEMAL	HURDHA	564	8190	3/516	283.8
		Behet	SEFER	XHEMAL	HURDHA	1484	8190	3/516	289.1
13	TIRANA JUG	Ishte	FIQIRETE	QAMIL	CELA	668	8240	4/411	8.2
		Behet	FIQIRETE	QAMIL	CELA	668	8240	4/410	107.3

14	DURRES	ishte	BUJAR	MAHMUT	KAREPI	1285	8511	11/318	311
		behet	BUJAR	MAHMUT	KAREPI	1285		11/318	521
15	ELBASAN	Ishte	NASI	PREN	DEDJA	4503	8521	16/372	130.22
		Behet	NOSI	PREN	DEDJA	4503, 1524	8521	16/372	319.8
LIDHJA G									
NR.RENDOR	**DREJTORIA**	**KORIGJIMI**	**EMER**	**ATESI**	**MBIEMER**	**NR. PROTOKOLLI I VETEDEKLARI MIT PER LEGALIZIM**	**ZONA KADASTRALE**	**NUMRI I PASURISE**	**SIPERFAQJA E PARCELES NDERTIMORE PER KALIM PRONESIE (m²)**
1	2	3	4	5	6	7	8	9	11
16	ELBASAN	Ishte	OSMAN	ZENEL	TAÇE	32/3	1842	9/268	3.22
			MONDI	OSMAN	TAÇE	32/2			
			LUAN	OSMAN	TAÇE	32/1			
		Behet	OSMAN	ZENEL	TAÇE	32/3	1842	9/268	340.2
			MONDI	OSMAN	TAÇE	32/2			
			LUAN	OSMAN	TAÇE	32/1			
17	TIRANA JUG	Ishte	GAZMEND	SHEFIK	HAKA	53	8190	9/91	280.38
		Behet	GAZMEND	OSMAN	HAKA	1787	8190	9/91	240.8
18	TIRANA JUG	Ishte	SUL	IBRAHIM	ALLARAJ	604	8190	9/291	389.52
		Behet	MEHDIJE	XHELADIN	ALLARAJ	1816	8190	9/291	389.52
			AGIM	SUL	ALLARAJ				
			PELLUMB	SUL	ALLARAJ				
			RIFAT	SUL	ALLARAJ				
			KAMIDE	SUL	ALLARAJ				
			LAVDERIM	SUL	ALLARAJ				
19	TIRANA JUG	Ishte	ELMAZ	RAMAZAN	LUZI	969	8190	7/688	308.9
		Behet	FADIL	RAMAZAN	LUZI	969	8190	7/688	308.9
			ELMAZ						
20	TIRANA JUG	Ishte	FERIT	NEZIR	PASHA	535	8190	9/191	378.26
		Behet	FERIT	NEZIR	PASHA	1770	8190	9/302	300.5
21	TIRANA JUG	Ishte	GAZMEND	SHEFIK	HAKA	53	8190	9/91	280.38
		Behet	GAZMEND	SHEFIK	HAKA	53	2704	9/91	234.0
22	TIRANA JUG	Ishte	BESIM	HYSEN	LLANI	187	8190	9/286	456.94
		Behet	BESIM	HYSEN	LLANI	1529	8190	9/286	334.2
			ARBEN	BESIM	LLANI				
23	TIRANA VERI	ISHTE	TRENDAFIL	ESTREF	GJOSHI	103 , 2763	8320	12/45	451.5
		BEHET	TRENDAFIL	ESTREF	GJOSHI	2763	8320	12/45	464
24	TIRANA VERI	ISHTE	SHEFQET	RAMIZ	MURATI	1050,1054	8330	3/659	378.9
		BEHET	SHEFQET	RAMIZ	MURATI	1050 , 1054	8330	3/659	500
LIDHJA H									
NR.RENDOR	**DREJTORIA**	**KORIGJIMI**	**EMER**	**ATESI**	**MBIEMER**	**NR. PROTOKOLLI I VETEDEKLARI MIT PER LEGALIZIM**	**ZONA KADASTRALE**	**NUMRI I PASURISE**	**SIPERFAQJA E PARCELES NDERTIMORE PER KALIM PRONESIE (m²)**
1	2	3	4	5	6	7	8	9	11
25	ELBASAN	Ishte	SHEFKI	RAKIP	PISHA	1076	8525	6/190	283.6
		Behet	VELSON	SHEFKI	PISHA	264, 1076, 7394	8525	6/190	352
			RAKIP	SHEFKI	PISHA				
26	TIRANA JUG	Ishte	IBRAHIM	LIMAN	BALLA	1585	8170	6/346	302.2
		Behet	IBRAHIM	LIMAN	BALLA	1585	8170	6/346	436.4
27	TIRANA VERI	ISHTE	FIQIRI	BEKTASH	ÇELA	123	8120	5/489	317
		ISHTE	FERUZE	GURI	ÇELA	25	8120	5/488	316
			KONSTANDIN	BEKTASH	ÇELA				
		BEHET	FIQIRI	BEKTASH	ÇELA	123	8120	5/489	461
			FERUZE	GURI	ÇELA				
			FATOS	BEKTASH	ÇELA				
			KONSTANDIN	BEKTASH	ÇELA				
28	TIRANA VERI	ISHTE	NAILE	CEN	LOGU	964	8210	7/604	264.5
		BEHET	NANIE	CENE	LOGU	964	8210	7/604	264.5
			QEMAL	MUHAMET	LOGU				

LIDHJA I									
NR.RENDOR	DREJTORIA	KORIGJIMI	EMER	ATESI	MBIEMER	NR. PROTOKOLLI I VETEDEKLARI MIT PER LEGALIZIM	ZONA KADASTRALE	NUMRI I PASURISE	SIPERFAQJA E PARCELES NDERTIMORE PER KALIM PRONESIE (m²)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	11
29	TIRANA JUG	Ishte	SAMI	AZIS	CANA	79	8190	6/303	188
		Behet	VALTER	BASHKIM	GORA	79	8190	6/303	169.7
30	TIRANA JUG	Ishte	SHKELQIM	RAMAZAN	SHADINI	213	3266	400/592	391
		Behet	DEFRIM	RAMAZAN	SHADINI	213	3266	400/592	391
			SHKELQIM	RAMAZAN	SHADINI				
31	TIRANA JUG	ISHTE	YLLI	SULEJMAN	KERCYKU	911	8190	15/590	335.6
			BEHAR						
			SYLEJMAN						
		BEHET	BEHAR	SULEJMAN	KERCYKU	911	8190	15/590	335.6
			YLLI						
32	TIRANA JUG	ISHTE	LULEZIM	BARJAM	BARDHI	963	8190	13/636	475
		BEHET	FLORA	BIKOLL	LULI	963	8190	13/636	475
33	TIRANA JUG	Ishte	FREDERIK	XHEMIL	BEQO	733	3266	400/225	266
		Behet	PIRO	MINA	DINE	733	3266	400/225	266
			FREDERIK	XHEMIL	BEQO				
34	TIRANA JUG	Ishte	NEXHAT	JONUZ	MELLANI	2	8180	8/593	335.7
		Behet	NEXHAT	JONUZ	MELLANI	2	8180	8/593	394.5
35	TIRANA JUG	Ishte	MYRTEZA	OSMAN	RENA	1141	8230	2/700	116
		Behet	MYRTEZA	OSMAN	RENA	1141	8230	2/700	118.3
LIDHJA J									
NR.RENDOR	DREJTORIA	KORIGJIMI	EMER	ATESI	MBIEMER	NR. PROTOKOLLI I VETEDEKLARI MIT PER LEGALIZIM	ZONA KADASTRALE	NUMRI I PASURISE	SIPERFAQJA E PARCELES NDERTIMORE PER KALIM PRONESIE (m²)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	11
36	TIRANA JUG	Ishte	PAJTIM		GOLEMI	1480	8190	11/580	500
		Behet	SHABAN	KAMER	BERDHOSHI	1480,449	8190	11/580	481
			PAJTIM	BESIM	GOLEMI				
37	TIRANA JUG	Ishte	MITER	KOL	MERVATAJ	1225	8190	11/590	497
			GJON	DED	DEDNDREJ				
		BEHET	BARDHE	NDUE	DEDNDREJ	1225	8190	11/590	497
			GJON	DED	DEDNDREJ				
38	TIRANA JUG	Ishte	PETRIT	MAHMUT	VELIA	344	8260	1/451	79
		Behet	ANULLOHET						
39	FIER	ISHTE	XHEVAIR	BARJAM	ISUFAJ	542	8531	7/350	385
		BEHET	XHEVAIR	BARJAM	ISUFAJ	542	8531	7/350	500
40	ELBASAN	ISHTE	SPIRO	NIKOLLA	DAFINA	8265	8522	9/396	101.9
		BEHET	TATJANA	MYRTEZA	DAFINA	8265	8522	9/396	101.9
41	ELBASAN	ISHTE	TAJAR	ALI	CANI	5	1842	8/381	82.2
		BEHET	FLAMUR	QANI	DOLLANI	6612	1842	8/381	129.7
42	DURRES	ishte	ILIR	MAHMUT	KAREPI	1286	8511	11/316	350
		behet	ILIR	MAHMUT	KAREPI	1286		11/316	520
43	DURRES	ishte	BUJAR	QAZIM	SHEHI	376	8517	90/12	462
		behet	BUJAR	QAZIM	SHEHI	376	8511	4/250	462
44	DURRES	ishte	MURAT	MYFIT	XHAFERRAJ	3375	8517	91/4	406
		behet	MURAT	MYFIT	XHAFERRAJ	3375	8511	4/276	406
45	DURRES	ishte	ALUSH	SULEJMAN	GJETA	1756	8517	2/33	361
		behet	ALUSH	SULEJMAN	GJETA	1756		2/30	625
LIDHJA K									
NR.RENDOR	DREJTORIA	KORIGJIMI	EMER	ATESI	MBIEMER	NR. PROTOKOLLI I VETEDEKLARI MIT PER LEGALIZIM	ZONA KADASTRALE	NUMRI I PASURISE	SIPERFAQJA E PARCELES NDERTIMORE PER KALIM PRONESIE (m²)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	11
46	TIRANA JUG	ISHTE	ILIRJAN	MUSTAFA	DEMIRI	2811	8230	1/370	125.6
			ROLAND	MUSTAFA	DEMIRI	3446	8230	1/369	206.6
		BEHET	ILIRJAN	MUSTAFA	DEMIRI	2811,3446,2809	8230	1/369	332.3
			ROLAND	MUSTAFA	DEMIRI				

47	TIRANA JUG	ISHTE	SABRI	XHEVAHIR	SKENDERI	2528	3321	436/154	636
		BEHET	SHKELQIM	XHEVAHIR	SKENDERI	2528	3866	436/154	636
			SABRI	XHEVAHIR	SKENDERI				
			VIKTOR	XHEVAHIR	SKENDERI				
			ZENEL	XHEVAHIR	SKENDERI				
			RAIMOND	XHEVAHIR	SKENDERI				
48	TIRANA JUG	Ishte	PERPARIM	MUSTAFA	SKONJA	2844	8230	1/189	349.1
		Behet	MIMOZA	IBRAHIM	BANI	945,3378	8230	1/189	293
49	TIRANA VERI	ISHTE	DALIP	SAFET	NAKO	438/05	8170	7/414	514
		BEHET	DALIP	SAFET	NAKO	993 , 438/05	8170	7/414	514
			YLLI	DALIP	NAKO				
50	DURRES	ISHTE	MUHAMET	HYSEN	GJUZI	3145	8518	42/82	318
		BEHET	MUHAMET	HYSEN	GJUZI	3145	8518	42/82	500
51	DURRES	ISHTE	ABAZ	ADAIL	MYFTARALLARI	9003	8511	5/1104	340
			FABIAN	ADAIL	MYFTARALLARI				
			MAKET	ADAIL	MYFTARALLARI				
			MEHUT	ADAIL	MYFTARALLARI				
		BEHET	ABAZ	ADAIL	MYFTARALLARI	9003	8511	5/1104	400
			FATRIAN	ADAIL	MYFTARALLARI				
			MAKET	ADAIL	MYFTARALLARI				
			MEHUT	ADAIL	MYFTARALLARI				

LIDHJA M

NR.RENDOR	DREJTORIA	KORIGJIMI	EMER	ATESI	MBIEMER	NR. PROTOKOLLI I VETEDEKLARIMIT PER LEGALIZIM	ZONA KADASTRALE	NUMRI I PASURISE	SIPERFAQJA E PARCELES NDERTIMORE PER KALIM PRONESIE (m²)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	11
52	TIRANA JUG	Ishte	EDUARD	KUJTIM	KARAMUCA	610	3292	60/86	312.5
		Behet	EDUART	KUJTIM	KARAMUCA	610	3292	60/86	312.5
			LEONARD						
			ALFRED						
53	TIRANA JUG	Ishte	DURIM	HEKURAN	PERE	834	8170	5/552	366.1
		Behet	MIRIAN	DURIM	PERE	834	8170	5/552	336.1
			DURIM	HEKURAN	PERE				
54	TIRANA JUG	Ishte	ASLLAN	KAPLLAN	HIDRI	454	3976	136/241	346.1
		Behet	MEHMET	IBRAHIM	SULA	926	3976	136/241	346.1

LIDHJA N

NR.RENDOR	DREJTORIA	KORIGJIMI	EMER	ATESI	MBIEMER	NR. PROTOKOLLI I VETEDEKLARIMIT PER LEGALIZIM	ZONA KADASTRALE	NUMRI I PASURISE	SIPERFAQJA E PARCELES NDERTIMORE PER KALIM PRONESIE (m²)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	11
55	ELBASAN	Ishte	SPIRO	TAHIR	PAPAJANI	5595	8525	30/125	214
		Behet	SPIRO	TAHIR	PAPAJANI	5595, 7848	8525	30/125	260.7
56	TIRANA JUG	ISHTE	PELLUMB	ZIJA	MECULI	1772	3976	7/448	324
		BEHET	DURIM	ZIJA	MECULI	1772		7/448	324
57	TIRANA JUG	Ishte	LULEZIM	HAMZA	DINGO	2083	2380	236/151	310
		Behet	SOKOL	HAMZA	DINGO	2083		236/151	310
			ERJON						
			LULEZIM						
58	TIRANA VERI	ISHTE	ASLLAN		KALOSHI	470	8330	1/657	244.7
		BEHET	ASLLAN	SALI	KALOSHI	2926	8330	1/657	270
59	TIRANA 2	ISHTE	EFTIM	ZISI	AVRAMI	710	8270	4/230	43.00
			AGIM	STAVRI	MARJANI				
			KISMETE	ISMAIL	ABDIU				
			ALKYZ	HAMZA	CERGA				
			KLEVIS	KUJTIM	BIÇAKU				
		BEHET	EFTIM	ZISI	AVRAMI	710	8270	4/230	43.00
			AGIM	STAVRI	MARJANI				
			KISMETE	ISMAIL	ABDIU				
			ARTAN	PULLUMB	MENE				
			KLEVIS	KUJTIM	BIÇAKU				
60	DURRES	ISHTE	ISLAM	RRAPUSH	CARJA	7515	8515	3/205	400
		BEHET	ISLAM	RRAPUSH	CARJA	7516	8515	3/205	500

LIDHJA P									
NR.RENDOR	DREJTORIA	KORIGJIMI	EMER	ATESI	MBIEMER	NR. PROTOKOLLI I VETEDEKLARIMIT PER LEGALIZIM	ZONA KADASTRALE	NUMRI I PASURISE	SIPERFAQJA E PARCELES NDERTIMORE PER KALIM PRONESIE (m²)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	11
61	TIRANA 2	ISHTE	ILIR	NIKO	ÇIKA	604	8270	5/360	28.8
			ANDONETA	GOLE	SPIRO				
			SPIRO	DHIMITER	MATA				
			LAZAR	PJETER	VLASHI				
			BAJRAM	ABAS	BAJRAKTARI				
		BEHET	ILIR	NIKO	ÇIKA	604	8270	5/360	31.7
			ANDONETA	GOLE	SPIRO				
			NIKOLLAQ	SPIRO	MATA				
			LAZAR	PJETER	VLASHI				
			BAJRAM	ABAS	BAJRAKTARI				
62	TIRANA 2	ISHTE	RESHAT	ISLAM	KASA	973	8250	3/272	45.7
			ILIR	SPIRO	JOTI	717			
			FATMIR	LUTFI	AGOLLI	916			
			ALBERT	KRISTOFOR	MIHALI	744			
			SAMI	SHERIF	DHEMBI	860			
		BEHET	RESHAT	ISLAM	KASA	1593	8250	3/272	45.7
			PIER	ILIR	JOTI	717			
			FATMIR	LUTFI	AGOLLI	916			
			ALBERT	KRISTOFOR	MIHALI	744			
			SAMI	SHERIF	DHEMBI	860			
63	TIRANA JUG	Ishte	SALI	HYSEN	DOBRANI	226	8180	5/738	303
		Behet	FERDI	SALI	DOBRANI	226	8180	5/738	260.0
64	ELBASAN	Ishte	SEFEDIN	SADIK	JAUPAJ	662	1389	2/95	37.5
		Behet	SEFEDIN	SADIK	JAUPAJ	662	1389	2/95	124.6
LIDHJA Q									
NR.RENDOR	DREJTORIA	KORIGJIMI	EMER	ATESI	MBIEMER	NR. PROTOKOLLI I VETEDEKLARIMIT PER LEGALIZIM	ZONA KADASTRALE	NUMRI I PASURISE	SIPERFAQJA E PARCELES NDERTIMORE PER KALIM PRONESIE (m²)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	11
